



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr. 1104/8 Prot.

Tiranë, më 14/05/2016

V E N D I M

Nr.52, Datë 14/05/2016

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË KRYER NË
BASHKINË BERAT, "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE
RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit Tematik dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*".

V E N D O S A:

I. "Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare" të ushtruar në Bashkinë Berat, për periudhën 01.01.2014 deri më 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetjet nga auditimi: Bashkia Berat nuk ka nisur zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja në lidhje me zhdëmtimin e shumës **41,785,210 lekë** dhe përkatësisht: në 18 raste në shumën 11,248,377 lekë nuk janë nxjerrë urdhër zhdëmtimet; nuk është kërkuar në rrugë ligjore arkëtimi për taksa dhe tatime të popullatës në shumën 24,486,000 lekë; nga Bashkia nuk është pranuar shuma 6,050,833 lekë, si dhe nuk janë zbatuar masat disiplinore për 5 punonjës të

Bashkisë dhe për 2 punonjës të institucioneve të varësisë, veprim në papajtueshmëri me shkronjat **j** dhe **k** nenet 15 e 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Rekomandim: Bashkia Berat të marrë masa, të zbatojë rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën nr. 1228/89 datë 27.0.2015.

Brenda datës 30.06.2016

2 - Gjetjet nga auditimi: Bashkia Berat, për vitet 2014-2015 nuk ka analizuar shkaqet e mos realizimit të buxhetit faktik, veprim në papajtueshmëri me nenin 2, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa dhe të analizuar shkaqet e mos realizimit të buxheti faktik, si dhe të përcaktoj përgjegjësitë përkatëse për çdo punonjës.

Brenda datës 30.06.2016

3 - Gjetjet nga auditimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat, për vitin 2014-2015 shpenzimet operative i ka parashikuar me rezerva dhe nuk ka analizuar shkaqet e mos realizimit të buxhetit faktik, veprim në papajtueshmëri me nenin 2, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa dhe të analizuar shkaqet e mos realizimit të buxheti faktik, si dhe të përcaktoj përgjegjësitë përkatëse.

Në vijimësi

4 - Gjetjet nga auditimi: Bashkia Berat nga viti 2011-2015, ka larguar nga puna 8 punonjës të administratës, ndërsa gjykata me vendim të formës së prerë ka vendosur detyrimin e Bashkisë Berat për largim të padrejtë nga puna të punonjësve në shumën **6,347,282 lekë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 6, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Rekomandim: Bashkia Berat të marrë masa, që në rastet e largimit nga puna të punonjësve, të zbatojë kërkesat e ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe nenin 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në vijimësi

5 - Gjetjet nga auditimi: Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat për viti 2014-2015, nuk janë bërë hyrje në magazinë **27 studime e projekte** në vlerën 27,040,475 lekë, veprim në papajtueshmëri me shkronjën f, neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat të marrë masa, dhe të bëjë hyrje në magazinë 27 studime e projekte në vlerën **27,040,475 lekë**, të cilët nuk janë bërë hyrje prej vitesh.

Brenda datës 30.06.2016

6 - Gjetjet nga auditimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat, për vitin 2014-2015 nuk ka arkëtuar detyrimet debitorë në shumën 18,319,540 lekë, veprim në papajtueshmëri me shkronjën g neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat të marrë masa dhe të kërkoj në rrugë ligjore arkëtimin e shumës **18,319,540 lekë**.

Brenda datës 30.06.2016

7 - Gjetjet nga auditimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat të marrë masa dhe të kërkoj në rrugë ligjore arkëtimin e shumës **41,450,358 lekë**, veprim në papajtueshmëri me shkronjën g neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Rekomandim: Për arkëtimin e detyrimeve tatimore **41,450,358 lekë**, bazuar në pikën 3 neni 70 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimet tatimore, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:**

a - T`u dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b - Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të regjistrimit të pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

c - Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

d - Në rast se Bizneset private edhe pas dërgimit të urdhër bllokimeve në Bankë dhe njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014, pasi të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.

e - Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashki, të evidentojë dhe njoftojë familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit, në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016".

Brenda datës 30.06.2016

8 - Gjetjet nga auditimi: Njësia Administrative Otllak në Bashkinë Berat, për vitin 2015 nuk ka arkëtuar nga familjet detyrimet për ujin e pijshëm nga familjarët në shumën **1,438,061 lekë**, veprim në papajtueshmëri me shkronjën **g** neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat të marrë masa, dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës **1,438,061 lekë**, detyrimet për ujin e pijshëm nga familjarët sipas pasqyrave bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.06.2016

9 - Gjetjet nga auditimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat, për vitin 2014 nuk ka likuiduar kreditorët për shërbimet e kryera në shumën **20,760,761 lekë**, veprim në papajtueshmëri me shkronjën **g** neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat, të marrë masa dhe të sigurojë fondet e nevojshme në shumën **20,760,761 lekë**, duke hartuar një grafik për likuidimin e detyrimeve kreditorë, në pajtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 5, datë 27.12.2014, "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura".

Në vijimësi

10 - Gjetjet nga auditimi: Drejtoria e Financës për vitin 2014-2015 në **17 raste**, në shumën 600,630 lekë, fletëdaljet e magazinës nuk janë nënshkruar nga marrësi në dorëzim i materialeve, veprim në papajtueshmëri me shkronjën **f** nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe pika 38 e 40, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve të njësive së sektorit publik".

Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat, të marrë masa që fletëdaljet e magazinës të nënshkruhen nga marrësi në dorëzim i materialeve.

Në vijimësi

11 - Gjetjet nga auditimi: Drejtoria e Financës, pasuritë e transferuara me VKM nr. 222, datë 13.02.2008, nr. 11, datë 04.01.2012, nr. 477, datë 16.07.2014, nr. 1049, datë 23.12.2015 dhe nr. 238, datë 18.03.2015 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave, që do të transferohen në pronësi të njësive vendore, Bashkinë Berat", nuk ka bërë rivlerësimin e tyre dhe nuk i ka paraqitur në Pasqyrat Financiare të vitit 2014, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", pika 3 e VKM nr. 248 date 10.04.1998 "Për Miratimin e Planit Kontabël Publik", të ndryshuar dhe UMF nr. 26, datë 27.12.2007 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet

qendrore, organet e pushtetit vendorë” dhe UMF. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat, të marrë masa dhe të bëjë rivlerësimin e pasurive të transferuara në pronësi të Bashkisë dhe ti paraqesë në Pasqyrat Financiare të vitit 2016.

Në vijimësi

12 - Gjetjet nga auditimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat, nuk ka bërë hyrje në magazinë një mjet Tip Kamioni me ndihma për familjet e përmbytura të dhuruara nga Bashkia Lovech e shtetit Bullgar, veprim në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe pikën 61, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandim: Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat, të marrë masa dhe të bëjë hyrje në magazinë të gjitha ndihmat e ardhura nga donatorë të ndryshëm.

Në vijimësi

13 - Gjetjet nga auditimi: Për vitin 2014, nga Drejtoria e Financës janë asgjësuar aktiveve të qëndrueshme qarkulluese të cilat nuk janë bërë hyrje në magazinë, si dhe aktivet e asgjësuar nuk janë marrë me fletëdalje nga magazina. Në procesverbalin e asgjësimit aktivet e qëndrueshme nuk janë paraqitur sipas emërimit, njësisë së matjes, sasisë së materialeve, çmimit, vlerës së materialeve, sa dorëzohen (shiten) si lëndë drusore dhe skrap, sa asgjësohen me djegie dhe sa me groposje, veprim në papajtueshmëri me shkronjën f pika 3 neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pika 103, 107, 108 dhe 109, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe pika 16, të UMB nr. 1151, datë 16.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë Brendshme”.

Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa, që aktivet jashtë përdorimit ti bëjë hyrje në magazinë, si dhe aktivet për asgjësim ti nxjerr nga magazina me fletëdalje. Në procesverbalin e asgjësimit të përcaktoj emërtimin, njësinë e matjes, sasinë e materialeve, çmimin, vlerën e materialeve, sa dorëzohen (shiten) me ankande publike si lëndë drusore dhe si skrap, sa asgjësohen me djegie dhe sa me groposje. Në procesin e asgjësimit të marrin pjesë Përgjegjësi i Shërbimeve dhe përgjegjësi material (magaziniери).

Në vijimësi

14 - Gjetjet nga auditimi: Bashkia Berat, për vitet 2014-2015 në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit ka planifikuar për punë civile **16 raste**, për të cilat kanë dalë urdhër prokurimi me afat të kryerjes së punimeve brenda vitit ushtrimor me vetëm 48 % të fondeve në dispozicion, ndërsa në asnjë rast nuk është përcaktuar se likuidimi i fondeve do të bëhet (kryhet) në vitin pasardhës, veprim në papajtueshmëri me neni 2, pika 1/b, neni 3 pika 5 dhe neni 24, të ligjit nr. 9396, datë 12.05.2005 “Për qiranë financiare” dhe neni 1, pika 1, 2, 4 neni 4, pika 1 neni 60 dhe pika 1 neni 76, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Rekomandim: Bashkia Berat të marrë masa, që procedurat e prokurimit që do ti kryejë brenda vitit ushtrimor t'i zhvillojë pasi fondet të jenë në dispozicion.

Në vijimësi

15 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat si Autoritet Kontraktor, nuk ka marrë masa për të realizuar brenda afatit kolaudimin e punimeve të ndërtimit për objektet: “Rikonstruksion i Shëtitores “Osumi” (Aksi kryesorë L = 83.10 ml, aksi1 L = 82.40 ml)”; “Rivitalizim i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale” dhe “Rikonstruksion i trotuareve, parmakëve dhe ndriçimit në segmenti Ura e Varur-Ura e Gorricës”, veprim në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin e Disiplinimit të Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar, me pikën 10.1, kreu II, UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për Zbatimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor në Bashkinë Berat, të marrë masat për të realizuar në kohë kolaudimin e punimeve të ndërtimit në objektet e përfunduara, në përputhje me afatet e kërkesat ligjore.

16 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat si Autoriteti Kontraktor nuk ka marrë masa, për të realizuar cilësinë e duhur sipas kushteve teknike dhe kërkesave teknike, lidhur me mbushjen e fugave me llaç-çimento për zërin e punimit “F.v. pllakë guri gri ranor me sipërfaqe të trajtuar t = 10 cm”, veprim në papajtueshmëri me kushtet e Kontratës datë 08.07.2014 “Për ndërtimin e objektit”.

Rekomandimi: Bashkia Berat si Autoritetit Kontraktor të marrë masa, të ndjekë eliminimin e defekteve të konstatuara për zërin “F. v. pllakë guri gri ranor me sipërfaqe të trajtuar t = 10 cm”, nga operatorëve ekonomik “██████ sh.p.k., objekt i cili është brenda periudhës së garancisë.

Brenda datës 30.06.2016

17 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat si Autoriteti Kontraktor, pas marrjes në dorëzim të objekteve: “Rikonstruksion i Shëtitores “Osumi” (Aksi kryesorë L = 83.10 ml, aksi 1 L = 82.40 ml” dhe Rivitalizim i Parkut Perëndimorë të Qendrës dhe nënkalimi i Unazës Perimetrale”, nuk ka marrë masa për të mirëmbajtur dhe për të mbrojtur nga dëmtimi objektet dhe njëkohësisht nuk ka denoncuar në organet e Rendit në asnjë rast në lidhje me dëmtimet e shkaktuara me vlerë 9,039,500 lekë, veprim në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe UKM nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve të njësishë së sektorit publik”.

Rekomandimi: Bashkia Berat të marrë masa, dhe të ndjekë eliminimin e dëmtimit të shkaktuar në objektin “Rikonstruksion i Shëtitores “Osumi” Berat (Aksi kryesorë L = 83.10 ml aksi 1 L = 82.40 ml” dhe të vendoset në funksionim sistemi i ndriçimit në objektin “Rivitalizim i Parkut Perëndimorë të Qendrës dhe nënkalimi i Unazës Perimetrale”.

Brenda datës 30.06. 2016

18 - Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Berat, për vitin 2014-2015, nuk ka realizuar të ardhura nga tatim taksat në shumën **51,506 mijë lekë**, përbënë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, nuk ka ushtruar kontrolle në bazë të ndarjes territoriale dhe nuk ka kryer kontrolle me metodat e përzgjedhjes me risk të subjekteve, nuk ka përpiluar dosjet e tatimpaguesve me të dhëna të përditësuara, dosjet janë pa inventarizuar, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, të ndryshuar.

Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Berat të marrë masa, për arkëtimin e detyrimeve tatimore në shumën **51,506 mijë lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimet tatimore, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:**

a - T’u dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

b - Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të regjistrimit të pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c - Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë “ të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

d - Në rast se Bizneset private edhe pas dërgimit të urdhrë bllokimeve në Bankë dhe njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014, pasi të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.

e - Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashki, të evidentojë dhe njoftojë familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit, në zbatim të

pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

f - Të ushtrojë kontrolle në bazë të ndarjes territoriale dhe nuk ka kryer kontrolle me metodat e përzgjedhjes me risk të subjekteve dhe të plotësojë, përditësojë dhe inventarizoj dosjet e subjekteve të regjistruara nga Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit.

Brenda datës 30.06.2016

19 - Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Investimeve, Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në **4 raste**, dokumentacioni tekniko-ligjor i subjekteve me leje zhvillimore ndërtimi janë me mangësi dhe konkretisht: “Strukturë Banimi dhe Shërbimi 8 kat tip 83/5 i adaptuar”, “Objekt prodhues në ish-Kaldajën e Kombinatit të Tekstileve”, “Rikonstruksion i katit përdhe të objektit 3 kat ish-ushqimorja” dhe “Rikonstruksion dhe përshtatje e kopshtit “Konstandin Leka” zyrat e reja të DAR Berat”, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, të ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Investimeve, Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (DIPKT), përpara përfundimit të objekteve dhe miratimit të leje të përdorimit, të bëjë plotësimin e dosjeve me të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor, të konstatuar në mungesë me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore.

Në vijimësi

20 - Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Investimeve, Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në **2 raste**, dokumentacioni tekniko-ligjor i subjekteve me leje zhvillimore ndërtimi janë me mangësi dhe konkretisht: “Banim dhe shërbim 8 kat + 1 kat nën tokë”, leje ndërtimi nr. 22, datë 24.12.2010, me subjekt ndërtues “■■■■ sh.p.k., leje përdorimi datë 19.14.2014 dhe objektin “Banim dhe shërbim 7 + 1 kat + 1 kat nën tokë”, leje ndërtimi nr. 3, datë 18.10.2013, me subjekt ndërtues ■■■■ sh.p.k., leje përdorimi datë 19.06.2015, pasi Vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesit, nuk ka konfirmuar situacionin përfundimtar të punimeve, duke pasqyruar vlerën përfundimtare të objektit, por vetëm se subjekti nuk ka detyrime tatimore të papaguara dhe vërtetimi lëshohet për pajisje me leje shfrytëzimi, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, të ndryshuar, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar.

Rekomandim: Drejtoria e Investimeve, Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit të marrë masa, që me subjekt ndërtues ■■■■ sh.p.k., dhe me subjekt ndërtues ■■■■ sh.p.k., të konfirmojnë zyrtarisht vlerën përfundimtare punimeve, sipas faturave tatimore, pasqyrave financiare dhe situacionit përfundimtar të punimeve, si dhe në rast të konstatimit vlerave tepër, të përlllogarisë diferencat për tu paguar nga secili subjekt.

Menjëherë

21 - Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit në Bashkinë Berat, nuk ka dërguar për regjistrimin në ZVRPP Berat të gjitha pasuritë në pronësi apo përdorim, si dhe për prona të cilat rezultojnë të zëna forcërisht, nuk janë marrë masat e nevojshme për lirimin e tyre nga zaptuesit dhe përdoruesit e paligjshëm, veprim në papajtueshmëri me pika 26 e 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandim: Bashkia Berat, Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurën ligjore për regjistrimin e pasurive të kaluara në pronësi, të mbaj dhe përditësojë regjistrin kontabël të aktiveve në pronësi apo administrim, si dhe për ato pasuri të cilat rezultojnë të zëna forcërisht të marrë masat për lirimin e tyre dhe vënin në funksion të tyre.

Brenda datës 30.06.2016

22 - Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Taksave, Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve dhe Drejtoria e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit, në Bashkinë Berat, kanë lidhur 2 Aktmarrëveshje për dhënie në përdorim të përkohshëm të hapësirave publike dhe konkretisht: Aktmarrëveshja nr. 3117/1, datë 01.12.2015, me shoqërinë ■■■■ shpk, Vlorë; dhe Aktmarrëveshja nr. 3733, datë 01.12.2015, me personin fizik “F.I.” Berat, kur duhet të ishte aplikuar VKM nr. 54, datë

05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Nga subjektet nuk është zbatuar pika 3.3 e aktmarrëveshjes pasi edhe pas mbarimit të afatit të kontratës datë 10.02.2016 subjektet rezultojnë në aktivitet të plotë.

Nuk është përcaktuar detyrimi për lidhjen e kontratës për furnizimin me energji elektrike të pajisjeve të instaluar me “OSHEE” sha, veprim i cili ka sjellë si pasojë që Bashkia Berat të ketë paguar më shumë për shpenzimin e energjisë të konsumuar nga pajisjet e instaluar se sa të ardhurat nga dhënia në përdorim e truallit.

Rekomandim: Bashkia Berat, Bashkia Berat, Drejtoria e Taksave, Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve dhe Drejtoria e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit, të marrin masa, dhe të kërkojnë lirim e hapësirave dhe kthimin e territorit në gjendjen e mëparshme.

Menjëherë

23 - Gjetje nga auditimi: Njësia Administrative ish-Komuna Roshnik, Berat, ka lidhur Kontratën e qirasë nr. 451 rep dhe 225 kol, datë 22.04.2014, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqëria “V...” sha, për një sipërfaqe 200 m²; dhe Kontratën e qirasë nr. 541 rep dhe 270 kol, datë 02.02.2012 në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqëria “V...” sha, për një sipërfaqe 200 m². Në Kontratën e qirasë si bazë ligjore është vendosur VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal” dhe VKM nr. 1064, datë 22.10.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, ndërsa duhet të ishte vendosur si bazë ligjore VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar me VKM nr. 735, datë 05.11.2014.

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit dhe Njësia Administrative Roshnik, të marrin masa, dhe të kërkojnë ndryshimin e bazës ligjore të kontratave.

Menjëherë

24 - Gjetje nga auditimi: Njësia Administrative ish-Komuna Roshnik, Berat, ka lidhur Kontratën datë 29.04.2014, në cilësinë e qiradhënësit dhe qiramarrës **Xh.B.** dhe Kontratën datë 02.03.2015, në cilësinë e qiradhënësit dhe qiramarrës **G.D.** Kontratat nuk janë protokolluar, por mbajnë datën dhe vulën e institucionit, nuk ndodhet vendimi i këshillit të komunës për dhënien me qira, pronat nuk janë regjistruar në ZVRPP Berat, si dhe Ekstrakt nga QKR për veprimtarinë, veprim në papajtueshmëri me nenin 8, 32 dhe 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me nenin 15, 17, 18, 29, 30, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullësor”, dhe nenin 678 të Kodit Civil “Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet”, për shkak se prona objekt i këtyre kontratave nuk është regjistruar në pronësi të Komunës.

Rekomandim: Bashkia Berat, Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit dhe Njësia Administrative Roshnik, të marrin masa, të kërkojnë plotësimin e dokumentacionit për secilën Kontratë të dhënies me qira të fondit kullësor, si dhe të aplikojnë në ZVRPP Berat, për regjistrimin e parcelave sipas VKM.

Menjëherë

25 - Gjetje nga auditimi: Njësia Administrative ish-Komuna Sinjë, Berat, me vendimi nr. 1, datë 27.02.2012, ka miratuar kërkesën e **V.A.** për parcelën nr. 76/11 me sipërfaqe 1,83 ha, nr. 76/18 me sipërfaqe 0,595 ha dhe nr. 76/19 me sipërfaqe 0,585 ha dhe me vendim nr. 2, datë 27.02.2011 ka miratuar kërkesën e **A.R.** për parcelën nr. 211/1 me sipërfaqe 0,5 ha, dhe nr. 211/15 me sipërfaqe 1,5 ha. Kontratat për dhënie me qira të tokës bujqësore për një periudhë 99 vjet nuk janë hartuar para noterit, por është përdorur kontrata tip sipas udhëzimit, si dhe nuk janë dërguar për regjistrimin në ZVRPP Berat, veprim në papajtueshmëri me nenin 803, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit dhe Njësia Administrative Sinjë, të marrin masa dhe të kërkojnë plotësimin e dokumentacionit për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandara dhe të aplikojnë në ZVRPP Berat, për regjistrimin e tyre, si

dhe të rishikohet afati i vlefshmërisë së kontratave duke përcaktuar si periudhë kohe jo më shumë se 30 vjet.

Menjëherë

26 - Gjetje nga auditimi: Njësia Administrative ish-Komuna Velabisht, Berat, ka lidhur Kontratën datë 11.11.2010, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqëria "P..." sha, për një sipërfaqe 500 m² dhe Kontrata **pa datë** viti 2013, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqëria "V..." sha, për një sipërfaqe 300 m². Baza ligjore e kontratave të qirasë duhet të ishte vendosur VKM nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me VKM nr. 735, datë 05.11.2014.

Rekomandim: Bashkia Berat, Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit dhe Njësia Administrative Velabisht, marrin masa dhe të kërkojnë rilidhjen e kontratave sipas akteve ligjore e nënligjore në zbatim.

Menjëherë

27 - Gjetje nga auditimi: Njësia Administrative ish-Komuna Velabisht, Berat, ka lidhur 12 kontrata për dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara. Kontratat për dhënie me qira të tokës bujqësore për një periudhë 99 vjet nuk janë hartuar para noterit, por është përdorur kontrata tip sipas udhëzimit, si dhe nuk janë dërguar për regjistrimin në ZVRPP Berat, veprim në papajtueshmëri me nenin 803, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodin Civil", të ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Berat, Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit dhe Njësia Administrative Velabisht, të marrin masa dhe të kërkojnë plotësimin e dokumentacioni për dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara dhe të aplikojnë në ZVRPP Berat, për regjistrimin e tyre, si dhe të rishikohet afati i vlefshmërisë së kontratave duke përcaktuar si periudhë kohe jo më shumë se 30 vjet.

Menjëherë

28 - Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i kryer nga grupi i auditimit të KLSH, mbi zbatimin e punimeve të objekteve me investime të Bashkisë është konstatuar se nga IMT dhe DPTKI nuk janë mbajtur akt konstatimi dhe Procesverbale për dënim me gjobë për objektin: "Rikonstruksion i shëtitores Osumi", ku nga ndërhyrja e paligjshme e shoqërisë sipërmarrëse "S..." shpk, në vlerën 162,878,983, duke dëmtuar segmenti 908-951, për hapje kanali me gjatësi 22,6 x 0,7 ml, duke prishur shtresë asfaltike dhe pa e rikthyer në gjendjen e mëparshme dhe segmenti që i përket piketës në gjatësinë 800 ml, kanal në gjatësi 36 ml, veprim në papajtueshmëri me ligji nr. 10119, datë 23.04.2009 "Planifikimin e Territorit", të ndryshuar dhe ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektoratin e ndërtimit", të ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Berat, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të marrë masa, dhe të aplikojë të gjitha penalitetet ligjore të parashikuara nga aktet ligjore në zbatim për subjektin i cili ka kryer ndërhyrjet e paligjshme në aksin rrugor, si dhe duke kërkuar rikthimin në gjendjen e mëparshme.

Menjëherë

29 - Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Berat, në **7 raste**, në shumën 1,430,000 lekë, nuk ka arkëtuar gjobat e vendosura ndaj subjekteve private, veprim në papajtueshmëri me nenin 22, 30 e 44, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Berat të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e gjobave në shumën **1,430,000 lekë**, të vendosura ndaj subjekteve private sipas pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Qershor 2016

30 - Gjetje nga auditimi: Policia bashkiake për vitin 2015 në procesverbale nuk ka përcaktuar bazën ligjore për shkeljet e konstatuara, si dhe **17 raste**, nuk ka arkëtuar gjoba në shumën **32.500 lekë**, që përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me

nenin 13, të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe të Komunës”, të ndryshuar.

Rekomandim: Policia bashkiake të marrin masa, dhe të përcaktojë bazën ligjore në procesverbale në lidhje me shkeljet e konstatuara dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumës **32.500 lekë**, gjoba të paarkëruar sipas pasqyrës në Raportin përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Qershor 2016

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në pikën 5 neni 13, pika 14 neni 43, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse (Vendimet ekzekutive) dhe të kërkojë në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në **vlerën 55,828,263 lekë, si më poshtë:**

1 - Gjetje nga auditimi: - Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat, për periudhën janar 2014 deri me 30 gusht 2015, ka paguar **L.M.** në pozicionin e Drejtorit të Auditit të Brendshëm me klasën II b, ndërsa duhet të ishte paguar me detyrë Përgjegjës Sektori me klasën III b, duke përfituar tepër në shumën 131,336 lekë, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Berat, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve të qeverisjes vendore për efekt page”, të ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e shumës **131,336 lekë**, nga zj. **L.M.**, paguar në pozicion Drejtor i Auditit të Brendshëm me klasën II b.

Brenda datës 30.06.2016

2 - Gjetje nga auditimi: - Drejtoria e Financës në Bashkinë Berat, për periudhën 2014-2015, anëtarët e këshillit të bashkisë i ka paguar pa marrë pjesë në mbledhjen e këshillit në shumën 2,615,927 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, veprim në papajtueshmëri me pika 2 neni 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e vlerës **2,655,927 lekë**, paguar 37 anëtar të këshillit të Bashkisë për ditët që nuk kanë marrë pjesë në mbledhjen, sipas pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.06.2016

3 - Gjetje nga auditimi: - Nga Drejtoria e Financës, për vitin 2014-2015 për automjetet e administratës dhe të policisë bashkiake nuk është bërë analiza e harxhimit të karburantit, duke mbivendosur datat në fletë udhëtime, ndërsa në disa raste fletë udhëtimet nuk janë nënshkruar nga nëpunësi udhëtues, e si pasoj duke harxhuar një sasi karburanti të pa justifikuar me dokumentacion në shumën **438,690 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me shkronjën f neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 438,690 lekë, të ndarë si më poshtë:

- vlera **243,426 lekë**, nga **M.H** me detyrë ish-shofer i policisë bashkiake, duke harxhuar karburanti të pa justifikuar me dokumentacion.

- vlera **108,364 lekë**, nga **B.P.** me detyrë shofer i policisë bashkiake, duke harxhuar karburanti të pa justifikuar me dokumentacion.
- vlera **12,842 lekë**, nga **F.H.** me detyrë shofer i administratës së Bashkisë, duke harxhuar karburanti të pa justifikuar me dokumentacion.
- vlera **74,058 lekë**, nga **E.T.** me detyrë shofer i administratës së Bashkisë, duke harxhuar karburanti të pa justifikuar me dokumentacion.

Brenda datës 30.06.2016

4 - Gjetje nga auditimi: - Bashkia Berat, me rastin e festave të fund vitit 2013 ka organizuar një aktivitet në shumën **73,440 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me pika 9, të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” të ndryshuar dhe pika 1/b, të VKM nr. 472, date 2.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e vlerës **73,440 lekë**, për Koktejl me rastin e festave të fund vitit sipas pasqyrës bashkëlidhur.

Brenda datës 30.06.2016

5 - Gjetje nga auditimi: - Bashkia Berat, me rastin e 7 Marsit të vitit 2014, ka organizuar një aktivitet në shumën **51,600 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me pika 9, të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” të ndryshuar dhe pika 1/b, të VKM nr. 472, date 2.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e vlerës **51,600 lekë**, për Koktejl me rastin e 7 Marsit, sipas pasqyrës bashkëlidhur.

Brenda datës 30.06.2016

6 - Gjetje nga auditimi: - Nga Komisioni i blerjeve me vlera të vogla për delegacionin Turk, është paguar fjetje në hotel ndërsa sipas programit datë 14.02.2015, delegacionin është larguar nga Berati, pagesa e hotelit në shumën **9,100 lekë përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin Bashkisë**, veprim në papajtueshmëri me pikën 61, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e vlerës **9,100 lekë**, nga **N.K. F.K.** dhe **F.K.** me detyrë anëtarë të komisionit të prokurimit me vlera të vogla pagesë për fjetje në hotel të delegacionit Turk.

Brenda datës 30.06.2016

7 - Gjetje nga auditimi: - Nga Komisioni i blerjeve me vlera të vogla në dy raste bashkëlidhur faturës tatimore nuk ndodhet urdhri i prokurimit, ndërsa urdhri i prokurimit është miratuar vetëm për blerjen e 4 copë Souvenire për dhurata për delegacione shuma **3,370 lekë**, që përbënë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe pikën 61, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e shumës **3,370 lekë**, të ndarë si më poshtë:

- vlera **1,123 lekë**, nga **N.K.** në cilësinë e anëtares së Komisionit Blerjeve Vogla.
- vlera **1,123 lekë**, nga **A.C.** në cilësinë e anëtares së Komisionit Blerjeve Vogla.
- vlera **1,123 lekë**, nga **F.K.** në cilësinë e anëtares së Komisionit Blerjeve Vogla.

Brenda datës 30.06.2016

8 - Gjetje nga auditimi: - Nga Komisioni i blerjeve me vlera të vogla në kundërshtim me urdhrin e prokurimit dhe procesverbalin e ofertave ekonomik janë paguar më shumë **10,000 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin Bashkisë**, veprim në papajtueshmëri me pika 61, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e shumës **10,000 lekë**, të ndarë si më poshtë:

- vlera **3,333 lekë**, nga **N.K.** në cilësinë e anëtares së Komisionit Blerjeve Vogla.
- vlera **3,333 lekë**, nga **A.C.** në cilësinë e anëtares së Komisionit Blerjeve Vogla.
- vlera **3,333 lekë**, nga **F.K.** në cilësinë e anëtares së Komisionit Blerjeve Vogla.

Brenda datës 30.06.2016

9 - Gjetje nga auditimi: - Nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Median janë shpenzuar Krem Aroma dhe çaj, ndërsa nuk ndodhet lista për pritje dhe përcjelljen e delegacioneve në lidhje me përdorimin e krem Aroma dhe çaj në shumën **27,500 lekë**, **që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë**, veprim në papajtueshmëri me pikën 1/c dhe 9 të VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e vlerës **27,500 lekë**, nga **E.D.** me detyrë Specialiste për Marrëdhëniet me Median, për shpenzimin e Krem Aroma dhe çaj.

Brenda datës 30.06.2016

10 - Gjetje nga auditimi: - Nga Komisioni i komisioni i vlerësimit të vlerës fillestare të automjetit që është shitur si skrap pesha e automjetit është zvogëluar pa argumentim dhe pa dokumentacion nga 2500 kg që është pesha sipas dokumentacionit në 1445 kg, ndërsa vlera **20,980 lekë**, **përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë**, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 neni 3, të ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, ku përcaktohet: “Ankand publik” është procedura e shitjes, nëpërmjet së cilës përcaktohen të drejtat e pronësisë që transferohen në formën e ofertës publike, në bazë të çmimit më të lartë të ofruar.”.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e vlerës **20,980 lekë**, nga **Ll.H. Kryetar, O.H.** dhe **N.K.** si anëtar të komisioni i vlerësimit të vlerës fillestare të automjetit që është shitur si skrap.

Brenda datës 30.06.2016

11 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat si Autoritet Kontraktor në tenderin e zhvilluar me objekt: “Rehabilitimi i fasadave përgjatë bulevardit Republika”, me fond limit 36.735.196 lekë, KVO mbas hapjes së tenderit në rrugë elektronike i ka kërkuar OE të shpallur fitues **■** shpk vërtetimin e energjisë elektrike të muajit shkurt, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa c, ç, d dhe neni 2 germa a, b, c, nenin 51, pika 2 dhe neni 53, pika 1, duke shkaktuar një dëm ekonomik në shumën **3,842,212 lekë**.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore në shumën 3,842,212 lekë, të ndarë si më poshtë:

- vlera **1,280,738 lekë**, nga **E.P.** me detyrë kryetare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vlerësim të gabuar të ofertës ekonomike për shpallje fitues të OE “**■**” shpk;
- vlera **1,280,738 lekë**, nga **F.K.** me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vlerësim të gabuar të ofertës ekonomike për shpallje fitues të OE **■**” shpk;
- vlera **1,280,738 lekë**, nga **M.S.** me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vlerësim të gabuar të ofertës ekonomike për shpallje fitues të OE “**■**” shpk;

Brenda datës 30.06.2016

12 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat si Autoritet Kontraktor në tenderin e zhvilluar me objekt: “Rikonstruksioni i trotuareve rruga Antipatrea, segmenti gjykatë Bashki”, me fond limit 14.166.680 lekë, KVO ka s’kualifikuar OE me vlerë më të vogël “**■**” shpk, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, pika 2, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën **964,515 lekë**.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore në shumën 964,515 lekë, të ndarë si më poshtë:

- vlera **32,151 lekë**, nga E.P. me detyrë kryetare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke s'kualifikuar OE me vlerë më të vogël "██████" shpk.
- vlera **32,151 lekë**, nga F.K. me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke s'kualifikuar OE me vlerë më të vogël "██████." shpk.
- vlera **32,151 lekë**, nga M.S. me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke s'kualifikuar OE me vlerë më të vogël "██████" shpk.

Brenda datës 31.05.2016

13 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat si Autoritet Kontraktor në tenderin e zhvilluar me objekt: "Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (Konviktet, viti 2015)", me fond limit 1.811.455 lekë, është s'kualifikuar OE ██████ shpk, pasi mungon sigurimi i ofertës sipas shtojcës 4, ndërsa dhe vërtetimi e OSSHE është i datës 07.01.2015, pa përfshirë muajin dhjetor. Sigurimi i ofertës është sipas kërkesave të AK dhe nuk përbën kusht për s'kualifikim, ndërsa s'kualifikimi për vërtetimin e OSSHE pasi është i datës 07.01.2015, pa përfshirë muajin dhjetor, është i drejtë, ndërsa është shpallur fitues OE "██████" shpk i cili shlyerjen e detyrimeve për pagesën e energjisë elektrike nuk e ka të maturuar, në një kohë që duhej të kishte paguar edhe muajin janar, veprim në papajtueshmëri me DST, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën **19,180 lekë**.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore në shumën 19,180 lekë, të ndarë si më poshtë:

- vlera **6,394 lekë**, nga E.P. me detyrë kryetare e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke s'kualifikuar OE me vlerë më të vogël "██████." shpk.
- vlera **6,394 lekë**, nga F.K. me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke s'kualifikuar OE me vlerë më të vogël "██████." shpk.
- vlera **6,394 lekë**, nga M.S. me detyrë anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, duke s'kualifikuar OE me vlerë më të vogël "██████." shpk.

Brenda datës 31.05.2016

14 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat si Autoritet Kontraktor në tenderin e zhvilluar me objekt: "Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (kopshte & çerdhe viti 2015)", me fond limit 5.588.010 lekë, procedura e prokurimit-kërkesë për propozim, pasi OE me vlerë më të ulët i shpallur fitues "██████" shpk, me vlerë të ofertës 5.524.860 lekë, është tërhequr nga tenderimi, ndërsa KVO nuk ka kërkuar konfiskimin e sigurimit të ofertës në kompaninë e sigurimeve ██████ me serie nr. 0046675, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën **111.800 lekë**, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 58, pika 5.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **111,800 lekë**, nga kompania e sigurimeve "██████" me numër serie 0046675 dhe nga OE "██████." shpk, për mos konfiskim të sigurimit të ofertës.

Brenda datës 30.06.2016

15 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat si Autoritet Kontraktor për një muaj ka zhvilluar urdhër prokurimi nr. 6, datë 12.02.2015 dhe nr. 11, datë 16.03.2015, ka bërë "Blerje ushqime", duke bërë copëzimin e fondit, vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 28, pika 2, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën **190,550 lekë**.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore në shumën 190,550 lekë, të ndarë si më poshtë:

- vlera **63,517 lekë**, nga K.Gj. me detyrë anëtar të Njesisë së Prokurimit, duke bërë copëzimin e fondeve për blerje ushqimesh.
- vlera **63,517 lekë**, nga M.K. me detyrë anëtar të Njesisë së Prokurimit, duke bërë copëzimin e fondeve për blerje ushqimesh.
- vlera **63,517 lekë**, nga H.D. me detyrë anëtar të Njesisë së Prokurimit, duke bërë copëzimin e fondeve për blerje ushqimesh.

Brenda datës 30.06.2016

16 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat si Autoritet Kontraktor për vitin 2014 për nevoja të Qendrës Ekonomike të Arsimit ka bërë blerje ushqime “Blerje ushqime për çerdhet e kopshtet”, me fond limit 6.583.430 lekë dhe “Blerje ushqime për konviktet”, me fond limit 1.235.865 lekë, duke bërë copëzim të fondeve, pasi mund të kishte zhvilluar një procedurë për blerje ushqimesh, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, pika 2, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën **169,113 lekë**.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore në shumën 169,113 lekë, të ndarë si më poshtë:

- vlera **56,371 lekë**, nga R.K. me detyrë anëtar të Njesisë së Prokurimit, duke bërë copëzimin e fondeve për blerje ushqimesh.
- vlera **56,371 lekë**, nga M.K. me detyrë anëtar të Njesisë së Prokurimit, duke bërë copëzimin e fondeve për blerje ushqimesh.
- vlera **56,371 lekë**, nga H.D. me detyrë anëtar të Njesisë së Prokurimit, duke bërë copëzimin e fondeve për blerje ushqimesh.

Brenda datës 30.06.2016

17 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat si Autoriteti Kontraktor, ndaj bashkimit të operatorëve ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k. & [REDAKTUAR] shpk në situacionin e volumeve për 4 zëra punimesh me volume pune të pa kryera në objektin “Rikonstruksion i Shëtitores “Osumi” (Aksi kryesorë L = 83.10 ml, aksi 1 L = 82.40 ml”, ka paguar më shumë 5,992,146 lekë, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, veprim në papajtueshmëri me kushtet e kontratës nr. 1548, datë 14.07.2014.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **5,992,146 lekë**, nga bashkimi i operatorëve ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k. & [REDAKTUAR] shpk paguar për volume të pakryera në objektin “Rikonstruksion i Shëtitores “Osumi” Berat (Aksi kryesorë L = 83 l ml, aksi 1 L = 82.4 ml”.

Brenda datës 30.06. 2016

18 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat si Autoriteti Kontraktor, ndaj bashkimit të operatorëve ekonomik [REDAKTUAR] shpk, në situacionin e punimeve është konstatuar një diferencë në kryerjen e volumit të punës për një zë punimi në objektin “Rivitalizim i Parkut Perëndimorë të Qendrës dhe nënkalimi i Unazës Perimetrale”, duke paguar më shumë 434,250 lekë, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, veprim në papajtueshmëri me kushtet e kontratës datë 8.07.2014.

Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **434,250 lekë**, nga bashkimi i operatorëve ekonomik [REDAKTUAR] shpk, për punime të pa kryera në objektin “Rivitalizim i Parkut Perëndimorë të Qendrës dhe nënkalimi i Unazës Perimetrale”.

Brenda datës 30.06. 2016

19 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat si Autoriteti Kontraktor, ndaj operatorit ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k. në situacionin e volumeve 7 zëra punimesh nuk janë kryer në objektin “Rikonstruksion i trotuareve, parmakëve dhe ndriçimit në segmenti Ura e Varur-Ura e Gorricës”, duke paguar më shumë **5,808,150 lekë**, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, veprim në papajtueshmëri me kushtet e kontratës nr. 856, datë 20.04.2015.

Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **5,808,150 lekë**, nga operatori ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k., për punime të pa kryera në objektin “Rikonstruksion i trotuareve, parmakëve dhe ndriçimit në segmenti Ura e Varur-Ura e Gorricës”.

Brenda datës 30.06. 2016

20 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat si Autoriteti Kontraktor dhe Projektuesi (njëkohësisht hartues i preventivit), kanë përcaktuar gabim vlerën çmim/njësi për një zë punimi për objektin

“Rikonstrukcion i Shëtitores “Osumi”, duke rritur në mënyrë fiktive fondin limit në vlerën 2,453,038 lekë, si diferencë ndërmjet rritjes fiktive me ndryshimin e vlerës së fondit limit të tenderuar me vlerën e preventivit fitues, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë në vlerën **1,887,884 lekë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 5, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, neni 28, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për Disa ndryshime të udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001, “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me pikën 12, VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” dhe me germat c, ç pika 2, kreu II, germën a, pika 1, germa a pika 2, kreu V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore në shumën 1,887,884 lekë, të ndarë si më poshtë:

- vlera **269,670 lekë**, nga K.M. në cilësinë e Projektuesit dhe hartuesit të preventivit të objektit;
- vlera **269,670 lekë**, nga F.N. në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor;
- vlera **269,670 lekë**, nga R.K. në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e preventivit të tenderuar;
- vlera **269,670 lekë**, nga T.H. në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e preventivit të tenderuar;
- vlera **269,670 lekë**, nga S.DH. në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e preventivit të tenderuar;
- vlera **269,670 lekë**, nga K.GJ. në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e preventivit të tenderuar;
- vlera **269,670 lekë**, nga V.Z. në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e preventivit të tenderuar.

Brenda datës 30.06. 2016

21 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat si Autoriteti Kontraktor dhe Projektuesi (njëkohësisht hartues i preventivit), kanë përcaktuar gabim vlerën çmim/njësi për 3 zëra punimesh për objektin “Rikonstrukcion i trotuarit, parmakëve dhe ndriçimit në segmentin Ura e Varur-Ura e Gorricës”, duke rritur në mënyrë fiktive fondin limit në vlerën 4,103,100 lekë, si diferencë ndërmjet rritjes fiktive me ndryshimin e vlerës së fondit limit të tenderuar me vlerën e preventivit fitues, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë në vlerën **2,962,515 lekë**, veprim në papajtueshmëri me nenin 5, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, neni 28, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për Disa ndryshime të udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001, “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” me pikën 12, VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” dhe me germat c, ç pika 2, kreu II, germën a, pika 1, germa a pika 2, kreu V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Rekomandimi: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore në shumën 2,962,515 lekë, të ndarë si më poshtë:

- vlera **493,752 lekë**, nga K.M. në cilësinë e Projektuesit dhe hartuesit të preventivit të objektit;
- vlera **493,752 lekë**, nga F.N. në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor;
- vlera **493,752 lekë**, nga R.K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Investimeve, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, sipas Rregullores ka detyrë për të kontrolluar vlerat e preventivave që tenderohen;
- vlera **493,752 lekë**, nga M.K. në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit;
- vlera **493,752 lekë**, nga K.Gj. në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit;

- vlera **493,752 lekë**, nga H.D, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit.

Brenda datës 30.06. 2016

22 - Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Investimeve, Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, për subjektet e pajisura me leje zhvillimore ndërtimi për objektin: “Rikonstruksion dhe përshtatje e kopshtit “Konstandin Leka”, “Rikonstruksion i Hotel Tomorit dhe shtesë anësore” dhe “Objekt banimi dhe shërbimi 6-kat me Podrum”, tarifën e fasadës e ka llogaritur më pak në shumën **86,586 lekë**, që përbënë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me Vendimin e Këshillit të Bashkisë “Për miratimin e paketës fiskale”.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore shumën 86,586 lekë, të ndarë si më poshtë:

- vlera **6,772 lekë**, nga “██████████” shpk, për objektin “Rikonstruksion dhe përshtatje e kopshtit “Konstandin Leka”.

- vlera **36,210 lekë**, nga “██████████” shpk, për objektin “Rikonstruksion i Hotel Tomorrit dhe shtesë anësore”.

- vlera **43,604 lekë**, nga “██████████” shpk, për objektin “Objekt banimi dhe shërbimi 6-kate me Podrum”.

Brenda datës 30.06.2016.

23 - Gjetje nga auditimi: Nga KLSH në Bashkinë Berat, për Kontratën nr. 237, datë 20.03.2013, lidhur ndërmjet Bashkisë Berat dhe “██████████” shpk, ka rekomanduar masë për shpërblim dëmi në vlerën 3,364,740 lekë, shumë e cila nuk është kontabilizuar që ka sjellë si pasojë që vlerës fillestare të rekomanduar (**3,364,740 lekë**) ti shtohet edhe detyrimi i llogaritur për 24 muaj të papaguar në vlerën 373,860 lekë/muaj (Janar 2014-Dhjetor 2015) shuma prej **8,972,640 lekë**, përbënë të ardhura të munguara me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkia.

Në lidhje me kontratën e mësipërme nga Kryetari i Bashkisë është nënshkruar edhe Aneksi i Kontratës nr. 2127, rep nr. 451 kol, datë 03.11.2015, pasi sipas kriterëve të konkurrimit të pranuar nga shoqëria “██████████” është përcaktuar se detyrimet për zhvillimin e pronës janë marrë përsipër nga shoqëria “██████████” Mosaplikimi i kontratës së enfiteozës ka lejuar që nga subjekti të mbahet sendi, pavarësisht vënies së tij në përdorim apo jo, në mënyrë të padrejtë, duke mos u paguar detyrimet kontraktuale, si dhe duke lejuar degradimin e tij, kur qëllimi i dhënies në enfiteozë është jo vetëm përfitimi i të ardhurave por edhe mirëmbajtja dhe përmirësimi i sendit, veprime në papajtueshmëri me VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshua.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin shumës **8,972,640 lekë**, si rezultat i mosaplikimit të vlerës së qirasë prej 373,860 lekë/muaj, ndaj subjektit “██████████” Këshilli Bashkiak, të marrë në shqyrtim të gjitha veprimet e mosveprimet e drejtuesve të bashkisë dhe njëherazi duke kërkuar nga “██████████” shlyerja e detyrimeve kontraktuale dhe rinegocimin e kushteve deri në zgjidhjen e aktmarrëveshjes.

Menjëherë

24 - Gjetje nga auditimi: Nga 37 kontrata për dhënie me qira të ambienteve në pronësi të Bashkisë, 13 subjekte me vlerë 304,265 lekë, nuk kanë përmbushur detyrimet, veprime në papajtueshmëri me VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **304,265 lekë**, nga mospagimi i vlerës së qirasë.

Menjëherë

25 - Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Berat dhe Q.B, është lidhur Kontrata datë 12.11.2014, me sipërfaqe 11 m² pa kundërshtëpërblim në formë huapërdorje deri me datë 31.01.2016, veprime në papajtueshmëri me pikën c, Kreu III, të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, të ndryshuar, duke shkaktuar **dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në shumën 16,500 lekë** (11 m² x 100 lekë/m² x 15 muaj).

Rekomandim: Bashkia Berat, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **16,500 lekë**, krijuar si rezultat i dhënies me qira pa kundërshpërblim Q.B.

Menjëherë

26 - Gjetje nga auditimi: Nga Njësia Administrative ish-Komuna Velabisht, Berat, është lidhur Kontratë qiraje datë 11.11.2010 ndërmjet komunës Velabisht dhe shoqëria "███" sh.a, për dhënie me qira të një sipërfaqe prej 500 m². Shoqëria ███ nuk ka shlyer detyrimet për dy vite në vlerën 452,000 lekë, që përbën të ardhura të munguara me dëm ekonomik për Bashkinë Berat, veprime në papajtueshmëri me VKM nr. 22, datë 09.01.2008 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal" dhe VKM nr. 1064, datë 22.10.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

Rekomandim: Bashkia Berat, Drejtoria e Menaxhimit të Pronave dhe Strehimit dhe Njësia Administrative Velabisht, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **452,000 lekë**, krijuar si rezultat i mos pagesës së qirasë nga P.C.

Menjëherë

27 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Berat në zbatim të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme", ka kryer procedurat për "Shpronësim të objektit Truall + Godinë 2 kat me sipërfaqe truall 200 m² dhe ndërtesë kati përdhe 373 m² dhe kati i parë 400 m², me subjekt të shpronësuar K.B, me vlerë shpronësimi 37,821,663 lekë, për realizimin e investimit publik "Ndërtim i Ishullit në lumin Osum". Bashkia Berat, në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, para fillimit të procedurës së shpronësimit duhet të vepronte për prishjen e objektit si ndërtim pa leje, duke aplikuar gjobë në vlerën 2,602,480 lekë, që përbën të ardhura të munguara me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Berat.

Komisioni në raport vlerësimi është bazuar në analizën e çmimit për njësi, ku për qytetin e Beratit është përcaktuar si tarifë çmimi prej 32,531 lekë/m², duke mos zbatuar UKM nr. 2, datë 06.08.2014, ku vlera për shpronësim do të paraqitej: 32,531 lekë/m² x 773 m² = 25,146,463 lekë, duke zbritur dhe normën e amortizimit për 17 vite në vlerën 1.15% do të kishim (17 x 1.15) 80.45% x 25,146,463 = 20,230,329 lekë, pra diferenca prej 4,916,134 lekë (25,146,463 - 20,230,329 lekë) është përfitim i padrejtë nga subjekti i shpronësuar K.B. Shuma **17,591,334 lekë** (37,821,663 - 20,230,329), përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Berat.

Rekomandim: Bashkia Berat, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **17,591,334 lekë**, krijuar si rezultat i aplikimit të gabuar të referencave ligjore në vlerësimin e truallit dhe objektit **për K.B.**, si dhe të vendosë gjobë në shumën **2,602,480 lekë**, si rezultat i kryerjes së punimeve pa leje ndërtimore. Këshilli Bashkiak, të marrë në shqyrtim të gjitha veprimet e mosveprimet e Bashkisë duke kërkuar prishjen e vendimit dhe llogaritjen e detyrimit dhe zbritjen e vlerës për shpronësim.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE:

Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

I. Mbështetur në nenin 58 "llojet e masave disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", dhe në nenin 44, të ligjit nr. 139, datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i rekomandojmë Komisionit disiplinor pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për 5 **punonjës** si më poshtë:

"Largim nga Shërbimi civil"

1 – E.P., me detyrë ish-N/kryetare Bashkie aktualisht specialiste në Drejtorinë e Tatim Taksave, në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkelje në 16 procedura të prokurimit publik.

- Në 8 procedura të prokurimit nuk është argumentuar numri i punonjësve me volumet e punës, veprim në papajtueshmëri me nenin 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

- Për vendosjen e kërkesës për vërtetimin e numrit të punonjësve përveç listë pagesave të sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga Administrata Tatimore, të shoqëruar edhe me Formularët e Deklarimit të pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për çdo muaj, si kërkesë e pa argumentuar, veprim në papajtueshmëri me UMF nr. 23, datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

- Kanë kërkuar që OE të paraqesë dokumentacion për fabrikë betoni në pronësi ose me qira shoqëruar me leje mjedisore, fabrika e betonit të mos jetë më larg se 20 km, ndërsa në procedurat e tjera të prokurimit nuk është vendosur ky kufizim, duke përdorur dy standarde, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa c, ç, d, dhe neni 2 germa a, b, c dhe neni 20, ku përcaktohet dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61 pika 2.

- Në dy procedura prokurimi të kërkesave që një numër punonjësish të pajisen me “Dëshmi nga IQT”, në një kohë që në procedurat e tjera të prokurimit të ngjashme nuk janë kërkuar.

- Në procedurën e prokurimit në objektin: “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale”, kanë vendosur kërkesa që OE duhet të ketë në stafin e tij dhe të siguruar Mjekun e Shoqërisë. NJHDT në vendosjen e këtij kriteri ka vendosur kufizime kohore, pasi ka kërkuar që OE t'a ketë mjekun e shoqërisë nga muaji dhjetor 2014 e në vazhdim, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa c, ç, d, dhe neni 2 germa a, b, c dhe neni 20, ku përcaktohet dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61 pika 2.

- Për mos ndjekjen e shtesës së kontratës nr. 855/3, datë 08.07.2015, me objekt “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”, pasi nuk ka dalë urdhër prokurimi, dhe nuk janë hartuar regjistra shtesë të parashikimit të prokurimeve publike, nuk ka kërkuar ngritjen e grupit të punës për hartimin e relacionit shpjegues, si dhe duke mos mbajtur procesverbalet ndërmjet palëve, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 57, 60 dhe 70.

- Për mos hartimin në 4 tendera të DT me objekt: “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (Konviktet)” dhe “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (kopshte & çerdhe)” për vitet 2014 dhe 2015, nuk është hartuar dokumentacion ku të përcaktoj numrin e nxënësve që përfitojnë bursën (ushqim e fjetje), frekuentimin dhe periudhën kohore. Nuk janë përcaktuar treguesit organo leptikë, fiziko kimikë, shqisorë, markerimi, etiketimi, standartet, mënyra e ruajtjes dhe transportimit si dhe cilësia e artikujve të kërkuar, për mos vendosjen e kërkesave specifike në NJHDT për mjetin, duke mos kërkuar mjet figuriferik për transport mishi, bylmeti, vezësh dhe për mallrat e tjera, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 27.

- Në dy procedura për “Blerje ushqime”, të zhvilluara brenda një muaji është bërë copëzimi e fondit në shumën 7.399.465 lekë (1.811.455 lekë + 5.588.010 lekë), veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, pika 2.

- Për përcaktimin në DT, në specifikimet teknike emërtimi për artikullin: Makarona Misko e Biskota Piknik, veprim në papajtueshmëri me nenin 23, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, pika 5.
- Për mos vendosjen e treguesve organo lepitkë, fiziko kimikë, shqisorë, markerimi, etiketimi, standardet, mënyra e ruajtjes dhe transportimit dhe cilësia e artikujve të kërkuar, veprim në papajtueshmëri me pikën 3 nenin 23, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.
- Në dy procedura për “Blerje ushqime”, të zhvilluara brenda një muaji kanë bërë copëzimin e fondeve në shumën 7.399.465 lekë (1.811.455 lekë + 5.588.010 lekë), veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, pika 2.
- Kontrata nr. 1548, datë 14.07.2014, për objektin: “Rikonstruksion i shëtitorës së bulevardit “Osumi”, me vlerë 135.732.486 lekë, të lidhur ndërmjet Bashkisë dhe operatorit ekonomik [REDAKTUAR] shpk, nënshkruar vetëm nga [REDAKTUAR] dhe nr. 1509, datë 08.07.2014 me objekt “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”, lidhur midis Bashkisë Berat dhe [REDAKTUAR], nënshkruar vetëm nga [REDAKTUAR] veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar, Kreu VII, pika 3 dhe “Kohëzgjatja e kontratës” pika b.
- Në dy procedura të prokurimit për blerje ushqime për nevoja të Qendrës Ekonomike të Arsimit (kopështe & cerdhe dhe konvikt) për vitin 2014, është bërë copëzimi i fondeve, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, pika 2 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 2, 57, pika 2
- KVO, është e njëjtë për të dy procedurat e prokurimit dhe ka hartuar raportet përmbledhëse për tenderin me objekt “Rikonstruksion i shëtitorës së bulevardit “Osumi”, Berat” më datë 26.06.2014 dhe për tenderin me objekt “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale” më datë 27.06.2014, në një kohë që për tenderin “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”, nuk duhej të shpallej fitues BOE, pasi nuk e plotëson numrin e fuqisë punëtore, si dhe kërkesën e “Dokumenta standarde të procedurës së hapur – punë”, shtojca 10, pika 2.

2 – L.B., me detyrë Drejtore Finance, në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkelje në 6 procedura të prokurimit publik.

- Për mos ndjekjen e zbatimit të kontratave, çka ka krijuar vlerën 1,700,000 lekë dëm ekonomik, detyrim kontraktor për mos pagesën e taksës tregut dhe parkimit nga agjentët privat për vitin 2013 dhe 2014, në kundërshtim me kontratat nr. 1473 datë 16.01.2013, nr. 1651 datë 31.12.2013, nr. 1472 datë 16.01.2013, nr. 1650 datë 31.12.2013, nr. 1471 datë 16.01.2013 dhe nr. 1474 datë 16.01.2013. Për anomali në hartimin e kontratave të tregut dhe parkimit, pasi nuk përcaktohen penalitetet, kontratat nuk shoqërohen harta e skica sipas shesheve dhe vendeve, për sipërfaqen dhe numrin e tregtarëve e automjeteve, dokumente bazë për saktësinë e vendosjes të vlerës në kontratë.
- Për krijimin e pa nevojshme të disa drejtorive, apo funksioneve çka ka bërë që disa punonjës të mos kenë ngarkesën e duhur në punë si: Zv/kryetar bashkie 3 veta, Kabineti i kryetarit 3 veta, Drejtoria e financës 12 veta (specialisti i buxhetit dhe ai i pagave nuk kanë ngarkesën e plotë), drejtoria e taksave vendore 11 veta, drejtoria ligjore dhe shërbimeve mbështetëse 16 veta Sktroi marrëdhënieve me publikun 3 persona dhe 3 administratorët e lagjeve nuk justifikojnë ngarkesën e punës etj.
- Për disa emëtime në pozicione pune të pajustificuara si, përgjegjësi i njësisë prokurimeve, përgjegjësi i sektorit biznesit e ardhurave, përgjegjësi i borxhit, përgjegjësi i menaxhimit kontratave, përgjegjësjë e sektorit juridik, përgjegjësjë e arkiv protokollit dhe përgjegjësjë e sektorit marrëdhënieve me publikun.

-Për marrjen në punë të disa punonjësve pa ju nënshtruar procesit të konkurrimit, në kundërshtim me ligjin nr. 8549 datë 11.11.1999 "Statusit i Nëpunësit Civil i ndryshuar" i ndryshuar, nenin 13 "Pranimi", pika 1.

- Për mos ndjekjen e proceduarve për shpalljen fitues të BOE "██████████", i cili paraqitet me mangësi në drejtim të plotësimit të kriterëve të vecanta të kualifikimit, në kushtet kur në kontratën e bashkimit të përkohshëm të shoqërive nuk ka të përcaktuar punët konkrete, si dhe OE nuk plotëson kriterin e numrit të punonjësve, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 1, datë 01.10.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, pika 2, germa a, c.

- Për mos ndjekjen e proceduarve për shpalljen fitues nga KVO të BOE, të cilët në dy prokurime kanë paraqitur të njëjtat makineri, fuqi punëtore duke mos plotësuar procedurat e tenderit. KVO, është e njëjtë për të dy procedurat dhe ka hartuar raportet përmbledhëse për tenderin me objekt "Rikonstruksion i shëtitorës së bulevardit "Osumi", më datë 26.06.2014 dhe për tenderin me objekt "Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale" më datë 27.06.2014, në një kohë që tenderin "Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale", nuk duhej të shpallej fitues pasi nuk plotëson numrin e fuqisë punëtore si dhe kërkesën "Dokumenta standarde të procedurës së hapur-punë", shtojca 10, pika 2, nënpika "Kapaciteti teknik".

3- M.S, me detyrë Drejtore e Administrimit të Pronave në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkelje në 17 procedura të prokurimit publik.

- Për mos ndjekje dhe për kualifikimin e operatorit ekonomi "██████████" shpk, në kushtet kur nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DT. "██████████" shpk, nuk plotëson kategoritë e licencës për punimet që ka marrë përsipër të kryejë si dhe numrin e punonjësve të kërkuar në përputhje me përqindjet e përcaktuara në kontratën e bashkimit përkohshëm të OE, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, neni 72 dhe 74, pika 3 dhe Udhëzimet e APP "Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin me mjete elektronike".

- Për mos ndjekjen dhe kualifikimin si ofertë të vlefshme të OE të mbetur në garë në kushtet kur nuk plotëson numrin e punonjësve për vitin 2012, i cili është kriter s'kualifikues dhe tenderi duhej të anulohet, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

- Për mos ndjekjen e proceduarave dhe duke shpallur fitues tenderët: "Rikonstruksion i trotuareve, parmakëve dhe ndriçimit në segmentin Ura e Varur - Ura e Goricës", i cili është hapur pas tenderit me objekt "Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror "Teodor Muzaka", përkatësisht "██████████" shpk "██████████", duke shpallur fitues "██████████" i cili ka deklaruar në të dy procedurat e prokurimit të njëjtin numër punonjësish, duke mos plotësuar kushtin e kërkuar për kualifikim, si dhe në 11 tendra ka paraqitur të njëjtat makineri e pajisje për të cilat është lidhur kontrata, duke mos plotësuar "Kriteret e veçanta të kualifikimit", nënpika "Kapaciteti teknik", si dhe shtojcën 10, pika 2, "Kriteret e veçanta të kualifikimit", nënpika "Kapaciteti teknik".

- Për mos ndjekjen e proceduarve duke kualifikuar në vend të parë të OE "██████████", pasi nuk plotëson kërkesën për përvojë të suksesshme në ekzekutimin e punëve të ngjashme të së njëjtës natyrë, për "Rehabilitimi i fasadave përgjatë bulevardit Republika", veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa c, ç, d, neni 2, germa a, b, c, nenin 51, pika 2, neni 53, pika 1, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 3,842,212 lekë.

- Për mos ndjekjen e proceduarve në s'kualifikimin në mënyrë të padrejtë nga KVO të BOE "██████████", duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 5,489,008 lekë, si dhe duke mos ruajtur të dhënat në mënyrë që të sigurojnë integritetin dhe kofidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

- Për mos ndjekjen e proceduarve në s`kualifikimin në mënyrë të padrejtë nga KVO të OE [REDACTED] shpk, me vlerë më të ulët të ofruar dhe për lëshimin e dokumenteve jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 964,515 lekë, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa c, ç, d, neni 2 germa a, b, c.
- Për mos ndjekjen e proceduarve në s`kualifikimin në mënyrë të padrejtë nga KVO, duke mos kontrolluar çmimet e paraqitura nga OE, në lidhje me llogaritjen e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 514, datë 15.08.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.
- Për mos ndjekjen e proceduarve në s`kualifikimin në mënyrë të padrejtë të OE [REDACTED] shpk me vlerë më të ulët, pasi sigurimi i ofertës është sipas kërkesave të DT, duke vepruar me dy standarde për shlyerje të detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 19.180 lekë, ndërsa kjo procedurë prokurimi duhej të anulohet, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.
- Për mos kërkimin nga KVO për konfiskimin e sigurimit të ofertës të OE [REDACTED] në kompaninë e sigurimeve [REDACTED] me numër serie 0046675, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 111.800 lekë, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 58, pika 5.
- Për mos ndjekjen e proceduarve për shpalljen fitues BOE “[REDACTED]” shpk, me mangësi në drejtim plotësimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në kushtet kur në kontratën e bashkimit të shoqërive nuk ka të përcaktuar punët konkrete për çdo OE, ndërsa OE [REDACTED] nuk plotëson kriterin e numrit të punonjësve, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 1, datë 01.10.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, pika 2, germat a, c.
- Për mos ndjekjen e proceduarve për shpalljen fitues të OE “[REDACTED]” shpk, ndërsa KVO ka klasifikuar BOE, i cili në dy prokurime kanë paraqitur të njëjtat makineri, të njëjtën fuqi punëtore dhe njëkohësisht nuk plotësojnë kushtet për tender. KVO, është e njëjtë për të dy procedurat dhe ka hartuar raportet përmbledhëse për tenderin me objekt “Rikonstruksion i shëtitorës së bulevardit “Osumi” më datë 26.06.2014 dhe për tenderin me objekt “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale” më datë 27.06.2014, në një kohë që tenderin “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”, nuk duhej ta shpallte fitues pasi nuk plotëson numrin e fuqisë punëtore si dhe kërkesën e “Dokumente standarde të procedurës së hapur-punë”, shtojca 10, pika 2, nënpika “Kapaciteti teknik”.

4 – M.K. me detyrë ish-Drejtores e Drejtorisë Juridike, me cilësinë e anëtares së Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), për shkelje në 15 procedura të prokurimit publik.

- Për mos planifikimin në regjistrin e prokurimeve për punë civile, pasi kanë dalë urdhra prokurimi dhe janë zhvilluar procedura tenderi pa fonde në dispozicion, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 185/2013 datë 2.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, ligjin nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 09/01/2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 1, 4, pika 1, 2, 4, neni 60 pika 1, neni 76 pika 1.
- Për hartimin në 8 procedura prokurimi, të dokumenteve të tenderit (DT), duke mos argumentuar kërkesat e veçanta për kualifikim, si dhe duke mos u përputhur volumet e punës me numrin e punonjësve, veprim në papajtueshmëri me nenet 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave

- profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.
- Për vendosjen e kërkesës së paraqitjes edhe të Formularit e Deklarimit të pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për çdo muaj, si kërkesë e pa argumentuar dhe e fryrë, veprim në papajtueshmëri me UMF nr. 23, datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
 - Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”, është kërkuar që OE të paraqesë dokumentacion për fabrikë betoni, në pronësi ose me qira shoqëruar me leje mjedisore. Në dy raste është kërkuar që fabrika e betonit të mos jetë më larg se 20 km, në një kohë që në procedurat e tjera të prokurimit të ngjashme nuk është vendosur ky kufizim, duke përdorur dy standarde. Artikulli “beton” gjendet në treg dhe nuk mund të detyrohen subjektet që të kenë në pronësi apo të marrin me qira fabrikë betoni, e cila nuk mund të përdoret si arsyetim nga subjektet ndërtuese për të justifikuar çmim e ofruar në një ofertë, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 74, pika 3 dhe me Udhëzimet e APP “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin me mjete elektronike”.
 - Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale” dhe “Rikonstruksioni i bibliotekës “V. Buharaja”, janë vendosur kërkesa që një numër punonjësish të pajisen me “Dëshmi nga IQT”, në një kohë që në procedurat e tjera të prokurimit të ngjashme nuk është kërkuar.
 - Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale”, është vendosur kërkesa që OE duhet të ketë në stafin e tij dhe të siguroar Mjekun e Shoqërisë. NJHDT në vendosjen e këtij kriteri ka vendosur kufizime kohore, pasi ka kërkuar që OE t’a ketë mjekun e shoqërisë nga muaji dhjetor 2014 e në vazhdim, ndërsa pika 3, e VKM nr. 741, datë 06.11.2003, e kërkon mjekun në mënyrë të përhershme, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa c, ç, d, dhe neni 2 germa a, b, c dhe neni 20, ku përcaktohet dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61 pika 2. Kjo kërkesë nuk është vendosur në procedurat e tjera të prokurimit të punimeve civile, duke vendosur dy standarde në përcaktimin e kërkesave.
 - Për mos zbatim të LPP për ankimimet e paraqitura për Dokumentet e Tenderit dhe për s`kualifikimet në procedurat e prokurimit për objektin: “Rikonstruksion i trotuareve, parrmakëve dhe ndriçimit në segmentin Ura e Varur - Ura e Gorricës”, “Rehabilitimi i fasadave përgjatë bulevardit Republika”, “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale”, “Rikonstruksioni i bibliotekës “V. Buharaja”, “Rikonstruksioni i trotuareve rruga Antipatrea, segmenti gjykatë Bashki”, “Blerje karburant”, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu X, neni 78, “pika 2 dhe pika 6, germa a, b, c dhe ç.
 - Në shtesën e kontratës nr. 855/3, datë 08.07.2015, me objekt: “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”, nuk ka urdhër prokurimi, nuk janë hartuar regjistra shtesë të parashikimit të prokurimeve publike, nuk ka kërkuar ngritjen e grupit të punës për hartimin e relacionit shpjegues, si dhe duke mos mbajtur procesverbalet ndërmjet palëve, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 57, 60 dhe 70.
 - Në DT e 4 tenderave, me objekt: “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (Konviktet)” dhe “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (kopshte & çerdhe)” për vitet 2014 dhe 2015, nuk është hartuar dokumentacion ku të përcaktohet numri i nxënësve që përfitojnë bursën (ushqim e fjetje), frekuentimin dhe periudhën kohore. Nuk janë përcaktuar treguesit organo leptikë, fiziko kimikë, shqisorë, markerimi, etiketimi, standartet, mënyra e ruajtjes dhe transportimit si dhe cilësia e artikujve të kërkuar veprim në pajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 27. Për mos ndjekjen e kërkesave specifike në NJHDT për mjetin, duke mos kërkuar mjet figuriferik për transport mishi, bylmeti, vezësh dhe për mallrat e tjera, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 27. Për mos përcaktimin e specifikimeve teknike në DT për artikujt: Makarona Misko e Biskota Piknik, veprim në papajtueshmëri me nenin 23, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, pika 5. Për mos përcaktimin e treguesve organo lepitkë, fiziko kimikë, shqisorë, markerimi, etiketimi, standardet, mënyra e ruajtjes, transportimit dhe cilësinë e kërkuar, veprim në papajtueshmëri me pikën 3 nenin 23, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

- Në dy procedura për “Blerje ushqime”, të zhvilluara brenda një muaji pasi janë bërë copëzime të fondit në shumën 7,399,465 lekë (1,811,455 lekë + 5,588,010 lekë), duke pasur fondet në dispozicion, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, pika 2.

- Në kontratat nr. 1548, datë 14.07.2014, për objektin: “Rikonstruksion i shëtitorës së bulevardit “Osumi”, me vlerë 135.732.486 lekë, të lidhur ndërmjet Bashkisë dhe operatorit ekonomik “██████████”, ka nënshkruar vetëm OE “██████████” dhe nr. 1509, datë 08.07.2014 me objekt “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”, lidhur midis Bashkisë Berat dhe “██████████” nënshkruar vetëm nga “██████████” veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar, Kreu VII, pika 3 dhe “Kohëzgjatja e kontratës” pika b.

- Në 2 procedura prokurimi për blerje ushqime për nevoja të Qendrës Ekonomike të Arsimit (kopshte & çerdhe dhe konvikt) për vitin 2014, është bërë copëzimi i fondeve dhe 21 artikuj janë me çmim më të lartë se proceduar e prokurimi në tjetrën, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, pika 2 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 2, 57, pika 2

- Për mos ndjekjen e proceduarve në përcaktimin e vlerës së fondit limit në preventivin e tenderuar, me objekt “Rikonstruksion e Shëtitorës “Osumi”, ku nga llogaritja e gabuar ka rezultuar rritje fiktive, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë në vlerën 2,962,515 lekë, veprim në papajtueshmëri me pikën 1, të nenit 28, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, me germën “a”, pika 1, gerrat “a” e “b”, të pikës 2, kreu V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me pikën 12, VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.

5 - B B, me detyrë Drejtor i Tatim Taksave, për periudhën 2014-2015.

- Për mos realizimin e të ardhurave nga tatim taksat vendore për vitin 2014-2015, në shumën **51, 506 mijë lekë**, për mos hartimin e dosjeve të tatimpaguesve me të dhëna të përditësuara, mos inventarizimin e dosjeve dhe mos ushtrimin kryesisht të kontrolleve verifikuese të adresave në bazë të ndarjeve territoriale, duke mos kryer kontrolle të natyrave të tjera të bazuar në metodat e përzgjedhjes me risk të subjekteve, si dhe mos hartimi i planeve të punës për Sektorin e Verifikimit në Terren, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjin 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzim i Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurën tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Udhëzim i përbashkët i Ministrit Brendshëm dhe Ministrit Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”.

- Për mos realizimin e të ardhurave nga dy subjekte me aktivitet hotelerie dike mos arkëtuar për vitin 2015, nga Hotel ████████ taksë fjetje në hotel në shumën **416.881 lekë** që përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë dhe nga Hotel ████████ në shumën **28.596 lekë** që përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjin 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat

tatimore”, Udhëzim i Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurën tatimore” të ndryshuar, Udhëzim i përbashkët i Ministrit Brendshëm dhe Ministrit Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”.

- Për mos përcaktimin e detyrimit për lidhjen e kontratës për furnizimin me energji elektrike të pajisjeve të instaluar me “OSHEE” sha, veprim i cili ka sjellë si pasojë që Bashkia Berat të ketë paguar më shumë për shpenzimin e energjisë të konsumuar nga pajisjet e instaluar se sa të ardhurat nga dhënia në përdorim e truallit, si dhe nga subjektet nuk është zbatuar pika 3.3 e aktmarrëveshjes pasi edhe pas mbarimit të afatit të kontratës datë 10.02.2016 subjektet rezultojnë në aktivitet të plotë. Në 2 raste të dhënies në përdorim të përkohshëm të hapësirave publike dhe konkretisht: Aktmarrëveshja nr. 3117/1, datë 01.12.2015, me shoqërinë [REDAKTUAR] shpk, Vlorë; dhe Aktmarrëveshja nr. 3733, datë 01.12.2015, me personin fizik [REDAKTUAR] Berat, duke mos u aplikuar VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

II- Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “b”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë që ti kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” parashikuar në nenin 58 shkronja (b), për 8 punonjës sa vijon:

1 – A.SH. me detyrë specialiste buxheti.

- Për mos analizimi i shkaqeve në realizimin e të ardhurave faktike për vitin 2013, 2014, 2015, tregon për një punë të pamjaftueshme të administratës për rritjen e shërbimeve ndaj qytetarëve të kësaj njësie të qeverisjes vendore, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

- Për mos realizimi i shpenzimeve financiare në Bashkinë Berat, tregon për një punë të pamjaftueshme në rritjen e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe për një planifikim jo të drejtë të fondeve buxhetore, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

- Për mangësitë e konstatuara në drejtim të programimit, zbatimit, evidentimit, ndjekjes dhe realizimit në nivele të pamjaftueshme të Buxhetit për vitet 2014-2015, vijnë në papajtueshmëri me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” dhe ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

2 – O.H. me detyrë specialiste finance për veprimet e magazinës.

- Për mos ndjekjen e analizës të shpenzimeve të karburantit sipas automjeteve, si dhe duke mos përcaktuar fushat me risk, duke e lënë jashtë kontrollit administrimin e karburantit në lidhje me lëvizjen e automjeteve të Bashkisë, duke krijuar parregullsi dhe zbatim të gabuar në përdorimin e fondeve publike, të cilat kanë pasojë të dëmshme në lidhje me shpenzimet financiare, veprim në papajtueshmëri me pikat 14, 20, 26 neni 3, shkronja dh, ë neni 12, pika 1 neni 17, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Për mos plotësimin e Fletë udhëtimet nuk përshkruajë me vërtetësi veprimet ose ngjarjen, që kanë për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore, personat që kanë urdhëruar dhe udhëtuar dhe të tjera të dhëna të nevojshme që e bëjnë fletë udhëtimin një dokument me një provë ligjore dhe administrative,

veprim në papajtueshmëri me pikat 14, 20, 26 neni 3, shkronja dh, ë neni 12, pika 1 neni 17, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Për mos identifikimin, vlerësimin dhe dokumentimin për garantimin e gjurmës së auditimit bazuar në kontrollet pas faktit, në lidhje me shpenzimin e karburantit, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në shumën **438,690 lekë**, veprim në papajtueshmëri me shkronjën f neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

3 – T.M. me detyrë ish-Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore, aktualisht N/Kryetare Bashkie.

- Për mos ndjekjen e analizës të shpenzimeve të karburantit sipas automjeteve, si dhe duke mos përcaktuar fushat me risk, duke e lënë jashtë kontrollit administrimin e karburantit në lidhje me lëvizjen e automjeteve të Bashkisë, duke krijuar parregullsi dhe zbatim të gabuar në përdorimin e fondeve publike, të cilat kanë pasoja të dëmshme në lidhje me shpenzimet financiare, veprim në papajtueshmëri me pikat 14, 20, 26 neni 3, shkronja dh, ë neni 12, pika 1 neni 17, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Për mos plotësimin e Fletë udhëtimet nuk përshkruajë me vërtetësi veprimet ose ngjarjen, që kanë për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore, personat që kanë urdhëruar dhe udhëtuar dhe të tjera të dhëna të nevojshme që e bëjnë fletë udhëtimin një dokument me një provë ligjore dhe administrative, veprim në papajtueshmëri me pikat 14, 20, 26 neni 3, shkronja dh, ë neni 12, pika 1 neni 17, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Për mos identifikimin, vlerësimin dhe dokumentimin për garantimin e gjurmës së auditimit bazuar në kontrollet pas faktit, në lidhje me shpenzimin e karburantit, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në shumën **438,690 lekë**, veprim në papajtueshmëri me shkronjën f neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

4 – H.D. me detyrë jurist, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, për shkelje në 15 procedura të prokurimit publik.

- Në hartimin e dokumenteve të tenderit, në procedurat e prokurimit për punë civile, sa vijon: “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional), suplementi i sheshit qendror “T. Muzaka”, “Rikonstruksion i trotuareve, parmakëve dhe ndriçimit në segmentin Ura e Varur – Ura e Goricës”, “Rehabilitimi i fasadave përgjatë bulevardit Republika”, “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale”, “Rikonstruksioni i bibliotekës “V. Buharaja”, Rikonstruksioni dhe rikualifikimi i rrugëve në lagjen “Donika Kastrioti”, Berat”, “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale” dhe “Rikonstruksion i shëtitores së bulevardit “Osumi”, Berat”, kërkesat e veçanta për kualifikim, pjesë e DT, janë të paargumentuara duke kërkuar që Operatorët Ekonomikë që të disponojnë sa vijon: Nivele të kategorisë së licencës për punime ndërtimi, më të larta se volumet e punimeve të vetë objektit dhe një numër të punonjësve të paargumentuar me volumet e punës, veprim në papajtueshmëri me nenet 8 e 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pasi niveli i punimeve që do të kryhen në këto procedura prokurimi për çdo kategori punimi dhe numri i punonjësve të kërkuar nuk përputhet me volumet e punës.

a - Për të vërtetuar numrin e punonjësve është kërkuar që të paraqiten Formularët e Deklarimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për secilin muaj, nga ku rezulton se është një kërkesë e pa argumentuar dhe e fryrë paraqitja edhe e këtij dokumenti pasi listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore, për pagimin e sigurimeve

shoqërore, janë mese të mjaftueshëm dhe të besueshëm për të vërtetuar kërkesën e punësimit dhe të sigurimit të punonjësve, kjo bazuar në UMF nr. 23, datë 09.12.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, të dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, të ndryshuar.

b - Në procedurat e prokurimit “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”, Berat” është kërkuar që OE të paraqesë dokumentacion për fabrikë betoni, për të cilën kërkohet që: “Për fabrikën e betonit duhet të paraqitet dokumenti i pronësisë, me qera ose certifikata e pronësisë, shoqëruar me leje mjedisore” dhe në dy raste është vendosur kërkesa që fabrika e betonit të mos jetë më larg se 20 km, në një kohë që në procedurat e tjera të prokurimit për punë civile të ngjashme nuk është vendosur ky kufizim, duke vendosur dy standarde në kërkesa dhe duke mos e argumentuar atë.

c - Nga auditimi rezultoi se në dy procedura prokurimi “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale” dhe “Rikonstruksioni i bibliotekës “V. Buharaja”, është vendosur kërkesa për një numër punonjësish të pajisur me “Dëshmi nga IQT”, në një kohë që në procedurat e tjera të prokurimit për punë civile të ngjashme nuk është vendosur ky kufizim duke vendosur dy standarde në kërkesa.

d - Nga auditimi rezultoi se nga ana e AK në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale”, është vendosur kërkesa që “OE duhet të ketë në stafin e tij dhe të siguruar sipas legjislacionit në fuqi Mjekun e Shoqërisë”. NJHDT në vendosjen e këtij kriteri ka vendosur kufizime kohore, pasi ka kërkuar që OE t’a ketë mjekun e shoqërisë nga muaji dhjetor 2014 e në vazhdim, në një kohë që VKM nr. 741, datë 06.11.2003, pika 3, e kërkon mjekun në mënyrë të përhershme. Kjo kërkesë nuk është vendosur në asnjë nga procedurat e tjera të prokurimit.

Sa më sipër, për përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, është vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa c, ç dhe d, dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, dhe neni 20, “Mosdiskriminimi”, në të cilën kërkohet se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tjera.”, duke shkaktuar pabarazi dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, pasi në procesverbalet e hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit, nuk ka asnjë argumentim dhe nuk justifikohen me volumet e punës kërkesat teknike ekonomike (kategoritë e licencës, numrin e punëtorisë, numrin dhe llojin e mjeteve, etj.), të përcaktuara nga NJHDT. Në të gjitha rastet e procedurave të prokurimit për punë civile nuk kanë bashkëpunuar për marrjen e kriterëve të veçanta për kualifikim nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban.

Në hartimin e DT për 4 tenderat me objekt “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (Konviktet)” dhe “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (kopshte & çerdhe)” për vitet 2014 dhe 2015, nuk ka asnjë dokumentacion ku të jetë përcaktuar numri i nxënësve që përfitojnë bursën (ushqim e fjetje), frekuentimi dhe mbi cfarë periudhe kohore është bazuar ky komision. Nuk na u vu në dispozicion asnjë analizë e kostos të mallrave, që do të prokurohen duke krahasuar elementët e më sipërm dhe specifikimet teknike të mallrave, punëve dhe shërbimeve përkatëse për të cilën ka dalë vlera limit e kontratave. Nuk ka asnjë të dhënë të paraqitur nga ky grup mbi numrin e nxënësve me burse dhe gjysëm burse. Specifikimet teknike të paraqitura në asnjë rast nuk kanë të përcaktuar treguesit organo leptikë, fiziko kimikë, shqisorë, markerimi, etiketimi, standardet, mënyra e ruajtjes dhe transportimit si dhe cilësia e artikujve të kërkuar. Në DT në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 27, “Kontratat e mallrave”, nuk është kërkuar mënyra e vërtetimit të kontratave të ngjashme nga sektori privat.

Nuk është përcaktuar asnjë kërkesë specifike për mjetin, nga NJHDT, nuk është kërkuar mjet frigoriferik i domosdoshëm për transportin e mishit dhe nënartikujve të tij, bulmetit e vezëve si dhe për transportin e mallrave të tjerë objekt i kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 27, “Kontratat e mallrave”. Në DT, në specifikimet teknike, janë përcaktuar referenca e markave e konkretisht për artikullin: Makarona Misko e Biskota Piknik, në papajtueshmëri me nenin 23 “Specifikimet teknike”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pika 5. Në 50 artikuj e prokuruar, në asnjë rast nuk janë përcaktuar treguesit organoleptikë, fiziko kimikë, shqisorë, markerimi, etiketimi, standardet, mënyra e ruajtjes dhe **transportimit dhe** cilësia e artikujve të kërkuar, objekt prokurimi, në kundërshtim me nenin 23 “Specifikimet teknike”, pika 3 e tij.

-Nga auditimi i dy procedurave me të njëjtin objekt “Blerje ushqime”, të zhvilluara brenda një muaji me urdhër prokurimi nr. 6, datë 12.02.2015 dhe nr. 11, datë 16.03.2015, rezulton se AK, ka bërë copëzimin e fondit prej 7.399.465 lekë (1.811.455 lekë + 5.588.010 lekë), duke i pasur fondet në dispozicion, duke vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, “Metodat e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike.”, pika 2, në të cilën është përcaktuar se: “Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara nga ky ligj.” me efekt ekonomik negativ për buxhetin e shtetit 190.550 lekë.

- Në zhvillimin e 2 procedurave të prokurimit për blerje ushqime për nevoja të Qendrës Ekonomike të Arsimit (kopshte & çerdhe dhe konvikt) për vitin 2014, nga copëzimi i fondeve, duke i pasur ato në dispozicion, në 21 artikuj është ofruar me çmim më të lartë nga njëra procedurë prokurimi në tjetrën, duke vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, “Metodat e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike.”, pika 2, në të cilën është përcaktuar se: “Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara nga ky ligj.”, duke shkaktuar një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit, me pasojë dëm ekonomik në shumën 169.113 lekë, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 2, “Prokurimi i përqendruar dhe organi qendror blerës” dhe nenin 57, “Njësia e prokurimit”, pika 2.

5 – F.K. me detyrë specialiste në Drejtorinë Juridike, në cilësinë Anëtare Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, **për shkelje në 10 procedura të prokurimit publik.**

Pasi ka kryer vlerësime në kundërshtim me kërkesat për kualifikim të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, për procedurat sa vijon:

“Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”, Berat”: kanë kualifikuar të parin dhe është lidhur kontratë me bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë (BOE) [REDAKTUAR] shpk, në kushtet kur ky BOE nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DT, pasi OE kryesues i BOE, [REDAKTUAR] nuk plotëson kategoritë e licencës për punimet që ka marrë përsipër të kryejë si dhe numrin e punonjësve të kërkuar në përputhje me përqindjet e përcaktuara në kontratën e bashkimit përkohshëm të OE, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 3. Nga auditimi i dokumentacionit ligjor administrativ të BOE të shpallur fitues “[REDAKTUAR] shpk, të paraqitur pranë KVO-së rezultoi se nuk ka përputhje midis tij dhe dokumentacionit të faqes elektronike të app.gov.al, pasi nuk janë paraqitur në mënyrë të dokumentuar: dokumentacion për xhiron mesatare vjetore për vitin 2011, certifikatën OHSAS 18001:2007, kontrata e bashkëpunimit dhe prokura e bashkimit të operatorëve ekonomikë, duke vepruar në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 72, “Zhvillimi i procedurave me mjete elektronike” si dhe me Udhëzimet e APP, “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin me mjete elektronike”,

Kanë shpallur fitues për tenderët me objekt: “Rikonstruksion i trotuareve, parmakëve dhe ndriçimit në segmentin Ura e Varur – Ura e Goricës, Berat”, i cili është hapur pas tenderit me objekt “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”, përkatësisht “██████████” nga ku nga auditimi rezulton se OE “██████████” të shpallur fitues në këtë tender ka deklaruar për dy procedurat e prokurimit të zhvilluara në të njëjtën kohë dhe me zbatim të kontratës me të njëjtën periudhë kohore të njëjtin numër punonjësish dhe makinerish, për të cilat është lidhur kontrata në të njëjtën ditë, dhe kanë ndërthurje kohore prej 60 ditësh, duke mos plotësuar “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nën-pika “Kapaciteti teknik”, si dhe shtojcën 10, pika 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nën-pika “Kapaciteti teknik”.

“Rehabilitimi i fasadave përgjatë bulevardit Republika”, kanë kualifikuar në vend të parë dhe është lidhur kontrata me OE “██████████” shpk në kushtet kur nuk plotëson: kërkesën për përvojë të suksesshme në ekzekutimin e punëve të ngjashme të së njëjtës natyre, si dhe nuk e ka të rregullt vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike ndërkohë që ka s’kualifikuar OE “██████████” shkuara për të ardhmen” shpk, me vlerë më të ulët të paraqitur në tender, në të njëjtat kushte për vërtetimin e pagesës së energjisë elektrike duke vepruar me dy standarde në vlerësim dhe në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa c, ç dhe d, dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, dhe nenin 51, “Ndalimi i modifikimit të ofertave”, pika 2, dhe neni 53, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 1, duke shkaktuar një efekt ekonomik negativ me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit prej: 3.842.212 lekë.

“Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale”, në zhvillimin e procedurës së prokurimit KVO ka vlerësuar të rregullta të dy ofertat pjesëmarrëse në tender. Me procesverbalin datë 11.05.2015, KVO pa asnjë lloj informacioni tjetër ka vlerësuar si ofertë joanomalisht të ulët vetëm “██████████” dhe sipas raportit përmbledhës bazuar në ankimimin e paraqitur nga “██████████” ka s’kualifikuar “██████████” shpk, në mënyrë të padrejtë nga KVO, duke shkaktuar efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit prej 5.489.008, lekë,

Nga auditimi rezultoi se OE “██████████” rezulton se disponon të dhëna të hollësishme për dokumentacionin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të OE “██████████” shpk. Theksojmë se këto dokumente janë hedhur në sistemin e prokurimit elektronik, i cili përdoret për përpunimin dhe ruajtjen (përfshirë edhe përpunimin digjital) të të dhënave, që transmetohen në rrugë elektronike, për kryerjen e procedurave të prokurimit. Ruajtja e të dhënave në këtë sistem kryhet në mënyrë që të sigurojnë integritetin e tyre dhe konfidencialitetin e ofertave e të kërkesave për pjesëmarrje.

“Rikonstruksioni i trotuareve rruga Antipatrea, segmenti gjykatë Bashki”, në zhvillimi i procedurës së prokurimit, është s’kualifikuar me të padrejtë OE “██████████” me vlerë më të ulët të ofruar prej 9.804.910 lekë, për mosnjohje nga ana e KVO-së të kërkesës që dokumentet të jenë lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës”, për moszbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 66, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, për vlerësim me dy standarde të vërtetimit për pagesa të maturuara të energjisë elektrike, duke vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa c, ç dhe d, dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, duke shkaktuar pabarazi dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë. Për rrjedhojë efekti ekonomik negativ me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit 964.515 lekë.

Në 10 raste KVO nuk ka kontrolluar çmimet e paraqitura nga OE në ofertat e tyre, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 514, datë 15.08.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 12, si dhe nuk janë kërkuar e dërguar ministrisë së linjës, në kundërshtim me VKM nr. 664, datë 26.9.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të KM, "Për informatizimin e

llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", pika 9.

“Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (Konviktet)”, në zhvillimin e procedurës së prokurimit ka s`kualifikuar OE [REDAKTUAR] me vlerë më të ulët, në kushtet kur sigurimi i ofertës është sipas kërkesave të DT si dhe ka vepruar me dy standarde në vlerësimin e dokumentacionit vërtetim për shlyerje të detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, duke shkaktuar një efekt financiar negativ me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, nga vlerësimi jo i drejtë i OE nga ana e KVO-së, në shumën 19.180 lekë , në një kohë që kjo procedurë prokurimi duhej të anulohet. Nga ana e KVO nuk është kërkuar konfiskimi i sigurimit të ofertës të OE [REDAKTUAR] veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 58, pika 5, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 111.800 lekë .

6 – V.Z. me detyrë specialist në Drejtorisë së Investimeve, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, **për shkelje në 5 procedura të prokurimit publik.**

- Për mos ndjekjen e proceduarve për shpalljen fitues të BOE “[REDAKTUAR]”, me mangësi në drejtim të plotësimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në kushtet kur në kontratën e bashkimit të përkohshëm të shoqërive nuk ka të përcaktuar punët konkrete, si dhe OE [REDAKTUAR] nuk plotëson kriterin e numrit të punonjësve, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 1, datë 01.10.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, pika 2, gërmat a, c.

Për mos ndjekjen e proceduarve për shpalljen fitues nga KVO të BOE, të cilët në dy prokurime kanë paraqitur të njëjtat makineri, fuqi punëtore duke mos plotësuar procedurat e tenderit. KVO, është e njëjtë për të dy procedurat dhe ka hartuar raportet përmbledhëse për tenderin me objekt “Rikonstruksion i shëtitores së bulevardit “Osumi”, më datë 26.06.2014 dhe për tenderin me objekt “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale” më datë 27.06.2014, në një kohë që tenderin “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”, nuk duhej të shpallej fitues pasi nuk plotëson numrin e fuqisë punëtore si dhe kërkesën “Dokumenta standarde të procedurës së hapur-punë”, shtojca 10, pika 2, nënpika “Kapaciteti teknik”.

Për mos ndjekjen e proceduarve në përcaktimin e vlerës së fondit limit në preventivin e tenderuar, me objekt “Rikonstruksion e Shëtitores “Osumi”, ku nga llogaritja e gabuar ka rezultuar rritje fiktive, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë në shumën 1,887,884 lekë, veprim në papajtueshmëri me pikën 1, të nenit 28, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, me germën “a”, pika 1, gërmat “a” e “b”, të pikës 2, kreu V, të VKM. nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me pikën 12, VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.

7 – G.Xh. me detyrë specialist tatim taksave.

- Për mos realizimin e të ardhurave nga tatim taksat vendore për vitin 2014-2015, në shumën **51, 506 mijë lekë**, për mos hartimin e dosjeve të tatimpaguesve me të dhëna të përditësuara, mos inventarizimin e dosjeve dhe mos ushtrimin kryesisht të kontroleve verifikuese të adresave në bazë të ndarjeve territoriale, duke mos kryer kontrole të natyrave të tjera të bazuar në metodat e përzgjedhjes me risk të subjekteve, si dhe mos hartimi i planeve të punës për Sektorin e Verifikimit në Terren, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjin 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, Udhëzim i Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurën tatimore” të ndryshuar, Udhëzim i përbashkët i Ministrit Brendshëm dhe Ministrit Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”.

- Për mos realizimin e të ardhurave nga dy subjekte me aktivitet hotelerie dike mos arkëtuar për vitin 2015, nga Hotel “[REDAKTUAR]” taksë fjetje në hotel në shumën **416.881 lekë** që përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë dhe nga Hotel [REDAKTUAR] në shumën **28.596 lekë** që përbëjnë të

ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjin 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, Udhëzim i Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurën tatimore” të ndryshuar, Udhëzim i përbashkët i Ministrisë Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore”.

8 – T.H., me detyrë specialist në Drejtorinë së Investimeve, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;

- Për mos ndjekjen e proceduarve në përcaktimin e vlerës së fondit limit në preventivin e tenderuar, me objekt “Rikonstruksion e Shëtitores “Osumi”, ku nga llogaritja e gabuar ka rezultuar rritje fiktive, duke shkaktuar **dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë, në vlerën 1,887,884 lekë**, veprim në papajtueshmëri me pikën 1, të nenit 28, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, me germën “a”, pika 1, gjerat “a” e “b”, të pikës 2, kreu V, të VKM. nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me pikën 12, VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D. 1. Për Agjencinë e prokurimit publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 4, 12, 19/7, 21, 23, 25, 28, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 53, 56, 63, etj, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet nr. 6, 7, 8, 9, 10, 11 datë 08.02.2016, nr. 12, 1 dhe 14 datë 09.02.2016, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), **9 punonjësve** si më poshtë:

1 – M.K., me detyrë ish-drejtor e Drejtorisë Juridike, me cilësinë e anëtares së Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), **për shkelje në 15 procedura të prokurimit publik.**

2 – H.D., me detyrë jurist, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, **për shkelje në 15 procedura të prokurimit publik.**

3 – E.P., me detyrë N/kryetare Bashkie, në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, **për shkelje në 16 procedura të prokurimit publik.**

4 – F.K., specialiste në Drejtorinë Juridike, në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, **për shkelje në 10 procedura të prokurimit publik.**

5 – M.S., me detyrë Drejtor e Pronave, në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, **për shkelje në 17 procedura të prokurimit publik.**

6 – L.B., me detyrë Drejtor Finance, në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, **për shkelje në 6 procedura të prokurimit publik.**

7 – V.Z., me detyrë specialist në Drejtorinë së Investimeve, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, **për shkelje në 5 - procedura të prokurimit publik.**

8 – R.K., me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Urban, në cilësinë e Kryetarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, **për shkelje në 6 procedura të prokurimit publik.**

9 – K.GJ, me detyrë ish-specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban, në cilësinë e Kryetarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, për shkelje në 15 procedura të prokurimit publik.

Në mënyrë të detajuar sa vijon:

1 – M.K, me detyrë ish Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe me cilësinë e anëtares së Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT).

- Për mos planifikimin në regjistrin e prokurimeve për punë civile, pasi kanë dalë urdhra prokurimi dhe janë zhvilluar procedura tenderi pa fonde në dispozicion, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 185/2013 datë 2.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, ligjin nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, Udhëzimin plotësues nr. 2, datë 09/01/2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 1, 4, pika 1, 2, 4, neni 60 pika 1, neni 76 pika 1.

- Për hartimin në 8 procedura prokurimi, të dokumenteve të tenderit (DT), duke mos argumentuar kërkesat e veçanta për kualifikim, si dhe duke mos u përputhur volumet e punës me numrin e punonjësve, veprim në papajtueshmëri me nenet 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

- Për vendosjen e kërkesës së paraqitjes edhe të Formularit e Deklarimit të pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për çdo muaj, si kërkesë e pa argumentuar dhe e fryrë, veprim në papajtueshmëri me UMF nr. 23, datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, të ndryshuar.

- Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”, është kërkuar që OE të paraqesë dokumentacion për fabrikë betoni, në pronësi ose me qira shoqëruar me leje mjedisore. Në dy raste është kërkuar që fabrika e betonit të mos jetë më larg se 20 km, në një kohë që në procedurat e tjera të prokurimit të ngjashme nuk është vendosur ky kufizim, duke përdorur dy standarde. Artikulli “beton” gjendet në treg dhe nuk mund të detyrohen subjektet që të kenë në pronësi apo të marrin me qira fabrikë betoni, e cila nuk mund të përdoret si arsyetim nga subjektet ndërtuese për të justifikuar çmim e ofruar në një ofertë, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 74, pika 3 dhe me Udhëzimet e APP “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin me mjete elektronike”.

- Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale” dhe “Rikonstruksioni i bibliotekës “V. Buharaja”, janë vendosur kërkesa që një numër punonjësish të pajisen me “Dëshmi nga IQT”, në një kohë që në procedurat e tjera të prokurimit të ngjashme nuk është kërkuar.

- Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale”, është vendosur kërkesa që OE duhet të ketë në stafin e tij dhe të siguroar Mjekun e Shoqërisë. NJHDT në vendosjen e këtij kriteri ka vendosur kufizime kohore, pasi ka kërkuar që OE t`a ketë mjekun e shoqërisë nga muaji dhjetor 2014 e në vazhdim, ndërsa pika 3, e VKM nr. 741, datë 06.11.2003, e kërkon mjekun në mënyrë të përhershme, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa c, ç, d, dhe neni 2 germa a, b, c dhe neni 20, ku përcaktohet dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61 pika 2. Kjo kërkesë nuk është vendosur në procedurat e tjera të prokurimit të punimeve civile, duke vendosur dy standarde në përcaktimin e kërkesave.

- Për mos zbatim të LPP për ankimimet e paraqitura për Dokumentet e Tenderit dhe për s`kualifikimet në procedurat e prokurimit për objektin: “Rikonstruksion i trotuareve, parmakëve

dhe ndriçimit në segmentin Ura e Varur - Ura e Gorricës”, “Rehabilitimi i fasadave përgjatë bulevardit Republika”, “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale”, “Rikonstruksioni i bibliotekës “V. Buharaja”, “Rikonstruksioni i trotuareve rruga Antipatrea, segmenti gjykatë Bashki”, “Blerje karburant”, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu X, neni 78, “pika 2 dhe pika 6, germa a, b, c dhe ç.

- Në shtesën e kontratës nr. 855/3, datë 08.07.2015, me objekt: “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”, nuk ka urdhër prokurimi, nuk janë hartuar regjistra shtesë të parashikimit të prokurimeve publike, nuk ka kërkuar ngritjen e grupit të punës për hartimin e relacionit shpjegues, si dhe duke mos mbajtur procesverbalet ndërmjet palëve, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 57, 60 dhe 70.

- Në DT e 4 tenderave, me objekt: “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (Konviktet)” dhe “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (kopshte & çerdhe)” për vitet 2014 dhe 2015, nuk është hartuar dokumentacion ku të përcaktohet numri i nxënësve që përfitojnë bursën (ushqim e fjetje), frekuentimin dhe periudhën kohore. Nuk janë përcaktuar treguesit organo leptikë, fiziko kimikë, shqisorë, markerimi, etiketimi, standartet, mënyra e ruajtjes dhe transportimit si dhe cilësia e artikujve të kërkuar veprim në pajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 27. Për mos ndjekjen e kërkesave specifike në NJHDT për mjetin, duke mos kërkuar mjet figuriferik për transport mishi, bulmeti, vezësh dhe për mallrat e tjera, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 27. Për mos përcaktimin e specifikimeve teknike në DT për artikujt: Makarona Misko e Biskota Piknik, veprim në papajtueshmëri me nenin 23, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, pika 5. Për mos përcaktimin e treguesve organo leptikë, fiziko kimikë, shqisorë, markerimi, etiketimi, standartet, mënyra e ruajtjes, transportimit dhe cilësinë e kërkuar, veprim në papajtueshmëri me pikën 3 nenin 23, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

- Në dy procedura për “Blerje ushqime”, të zhvilluara brenda një muaji pasi janë bërë copëzime të fondit në shumën 7,399,465 lekë (1,811,455 lekë + 5,588,010 lekë), duke pasur fondet në dispozicion, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, pika 2.

- Në kontratat nr. 1548, datë 14.07.2014, për objektin: “Rikonstruksion i shëtitores së bulevardit “Osumi”, me vlerë 135.732.486 lekë, të lidhur ndërmjet Bashkisë dhe operatorit ekonomik “S...”shpk & “B...” shpk, ka nënshkruar vetëm OE “██████████”shpk dhe nr. 1509, datë 08.07.2014 me objekt “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”, lidhur midis Bashkisë Berat ██████████, nënshkruar vetëm nga “██████████” veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar, Kreu VII, pika 3 dhe “Kohëzgjatja e kontratës” pika b.

- Në 2 procedura prokurimi për blerje ushqime për nevoja të Qendrës Ekonomike të Arsimit (kopshte & çerdhe dhe konvikt) për vitin 2014, është bërë copëzimi i fondeve dhe 21 artikuj janë me çmim më të lartë se proceduar e prokurimi në tjetrën, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, pika 2 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 2, 57, pika 2

- Për mos ndjekjen e proceduarve në përcaktimin e vlerës së fondit limit në preventivin e tenderuar, me objekt “Rikonstruksion e Shëtitores “Osumi”, ku nga llogaritja e gabuar ka rezultuar rritje fiktive, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë në vlerën 2,962,515 lekë, veprim në papajtueshmëri me pikën 1, të nenit 28, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, me germën “a”, pika 1, gerrat “a” e “b”, të pikës 2, kreu V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me pikën 12, VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.

2 – H.D. me detyrë jurist, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit.

- Në hartimin e dokumenteve të tenderit (**DT**), në 8 procedura të prokurimit nuk ka bërë argumentimin e numrit të punonjësve me volumet e punës, veprim në papajtueshmëri me nenet 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

- Për vendosjen e kërkesës për vërtetimin e numrit të punonjësve përveç listë pagesave të sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga Administrata Tatimore, të shoqëruar edhe me Formularët e Deklarimit të pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për çdo muaj, si kërkesë e pa argumentuar, veprim në papajtueshmëri me UMF nr. 23, datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, të ndryshuar. - Për mos ndjekjen e procedurave të prokurimit, duke kërkuar që OE të paraqesë dokumentacion për fabrikë betoni në pronësi ose me qira shoqëruar me leje mjedisore, fabrika e betonit të mos jetë më larg se 20 km, ndërsa në procedurat e tjera të prokurimit nuk është vendosur ky kufizim, duke përdorur dy standarde, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa c, ç, d, dhe neni 2 germa a, b, c dhe neni 20, ku përcaktohet dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61 pika 2.

- Në 4 tendera në DT me objekt: “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (Konviktet)” dhe “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (kopshte & çerdhe)” për vitet 2014 dhe 2015, nuk është hartuar dokumentacion ku të përcaktoj numrin e nxënësve që përfitojnë bursën (ushqim e fjetje), frekuentimin dhe periudhën kohore. Nuk janë përcaktuar treguesit organo leptikë, fiziko kimikë, shqisorë, marketimi, etiketimi, standartet, mënyra e ruajtjes dhe transportimit si dhe cilësia e artikujve të kërkuar veprim në pajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 27.

- Për mos vendosjen e kërkesave specifike në NJHDT për mjetin, duke mos kërkuar mjet frigoriferik për transport mishi, bulmeti, vezësh dhe për mallrat e tjera, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 27.

- Në dy procedura për “Blerje ushqime”, të zhvilluara brenda një muaji është bërë copëzimi i fondeve në shumën 7.399.465 lekë (1.811.455 lekë + 5.588.010 lekë), veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, pika 2.

- Për mos ndjekjen e proceduarve në përcaktimin e vlerës së fondit limit në preventivin e tenderuar, me objekt: “Rikonstruksion e Shëtitores “Osumi”, ku nga llogaritja e gabuar ka rezultuar rritje fiktive, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë në vlerën **2,962,515 lekë**, veprim në papajtueshmëri me pikën 1, të nenit 28, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, me germën “a”, pika 1, gjerat “a” e “b”, të pikës 2, kreu V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me pikën 12, VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.

3 – E.P. me detyrë ish-N/kryetare Bashkie dhe në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, aktualisht me detyrë specialiste në Drejtorinë e Tatim Taksave.

- Në 8 procedura të prokurimit nuk është argumentuar numri i punonjësve me volumet e punës, veprim në papajtueshmëri me nenin 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

- Për vendosjen e kërkesës për vërtetimin e numrit të punonjësve përveç listë pagesave të sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga Administrata Tatimore, të shoqëruar edhe me

Formularët e Deklarimit të pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për çdo muaj, si kërkesë e pa argumentuar, veprim në papajtueshmëri me UMF nr. 23, datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, të ndryshuar.

- Kanë kërkuar që OE të paraqesë dokumentacion për fabrikë betoni në pronësi ose me qira shoqëruar me leje mjedisore, fabrika e betonit të mos jetë më larg se 20 km, ndërsa në procedurat e tjera të prokurimit nuk është vendosur ky kufizim, duke përdorur dy standarde, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa c, ç, d, dhe neni 2 germa a, b, c dhe neni 20, ku përcaktohet dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61 pika 2.

- Në dy procedura prokurimi të kërkesave që një numër punonjësish të pajisen me “Dëshmi nga IQT”, në një kohë që në procedurat e tjera të prokurimit të ngjashme nuk janë kërkuar.

- Në procedurën e prokurimit në objektin: “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale”, kanë vendosur kërkesa që OE duhet të ketë në stafin e tij dhe të siguruar Mjekun e Shoqërisë. NJHDT në vendosjen e këtij kriteri ka vendosur kufizime kohore, pasi ka kërkuar që OE t`a ketë mjekun e shoqërisë nga muaji dhjetor 2014 e në vazhdim, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa c, ç, d, dhe neni 2 germa a, b, c dhe neni 20, ku përcaktohet dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61 pika 2.

- Për mos ndjekjen e shtesës së kontratës nr. 855/3, datë 08.07.2015, me objekt “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”, pasi nuk ka dalë urdhër prokurimi, dhe nuk janë hartuar regjistra shtesë të parashikimit të prokurimeve publike, nuk ka kërkuar ngritjen e grupit të punës për hartimin e relacionit shpjegues, si dhe duke mos mbajtur procesverbalet ndërmjet palëve, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 57, 60 dhe 70.

- Për mos hartimin në 4 tendera të DT me objekt: “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (Konviktet)” dhe “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (kopshte & çerdhe)” për vitet 2014 dhe 2015, nuk është hartuar dokumentacion ku të përcaktoj numrin e nxënësve që përfitojnë bursën (ushqim e fjetje), frekuentimin dhe periudhën kohore. Nuk janë përcaktuar treguesit organo leptikë, fiziko kimikë, shqisorë, markerimi, etiketimi, standartet, mënyra e ruajtjes dhe transportimit si dhe cilësia e artikujve të kërkuar, për mos vendosjen e kërkesave specifike në NJHDT për mjetin, duke mos kërkuar mjet figuriferik për transport mishi, bulmeti, vezësh dhe për mallrat e tjera, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 27.

- Në dy procedura për “Blerje ushqime”, të zhvilluara brenda një muaji është bërë copëzimi e fondit në shumën 7.399.465 lekë (1.811.455 lekë + 5.588.010 lekë), veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, pika 2.

- Për përcaktimin në DT, në specifikimet teknike emërtimi për artikullin: Makarona Misko e Biskota Piknik, veprim në papajtueshmëri me nenin 23, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, pika 5.

- Për mos vendosjen e treguesve organo leptikë, fiziko kimikë, shqisorë, markerimi, etiketimi, standartet, mënyra e ruajtjes dhe transportimit dhe cilësia e artikujve të kërkuar, veprim në papajtueshmëri me pikën 3 nenin 23, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

- Në dy procedura për “Blerje ushqime”, të zhvilluara brenda një muaji kanë bërë copëzimin e fondeve në shumën 7.399.465 lekë (1.811.455 lekë + 5.588.010 lekë), veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, pika 2.

- Në kontratEN nr. 1548, datë 14.07.2014, për objektin: “Rikonstruksion i shëtitorës së bulevardit “Osumi”, me vlerë 135.732.486 lekë, të lidhur ndërmjet Bashkisë dhe operatorit ekonomik

“[REDAKTUAR] ka nënshkruar vetëm OE [REDAKTUAR] dhe nr. 1509, datë 08.07.2014 me objekt “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”, lidhur midis Bashkisë Berat dhe “[REDAKTUAR] nënshkruar vetëm nga “[REDAKTUAR] veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar, Kreu VII, pika 3 dhe “Kohëzgjatja e kontratës” pika b.

- Në dy procedura të prokurimit për blerje ushqime për nevoja të Qendrës Ekonomike të Arsimit (kopshte & çerdhe dhe konvikt) për vitin 2014, është bërë copëzimi i fondeve, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, pika 2 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 2, 57, pika 2

- KVO, është e njëjtë për të dy procedurat e prokurimit dhe ka hartuar raportet përmbledhëse për tenderin me objekt “Rikonstruksion i shëtitores së bulevardit “Osumi”, Berat” më datë 26.06.2014 dhe për tenderin me objekt “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale” më datë 27.06.2014, në një kohë që për tenderin “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”, nuk duhej të shpallej fitues BOE, pasi nuk e plotëson numrin e fuqisë punëtore, si dhe kërkesën e “Dokumenta standarde të procedurës së hapur – punë”, shtojca 10, pika 2.

4 – F.K. me detyrë specialiste në Drejtorinë Juridike dhe në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- Për mos ndjekjen e procedurës së prokurimit për objektin: “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”, duke kërkuar që OE të paraqesë dokumentacion për fabrikë betoni, në pronësi ose me qira shoqëruar me leje mjedisore. Në dy raste është kërkuar që fabrika e betonit të mos jetë më larg se 20 km, në një kohë që në procedurat e tjera të prokurimit të ngjashme nuk është vendosur ky kufizim, duke përdorur dy standarde. Artikulli “beton” gjendet në treg dhe nuk mund të detyrohen subjektet që të kenë në pronësi apo të marrin me qira fabrikë betoni, e cila nuk mund të përdoret si arsyetim nga subjektet ndërtuese për të justifikuar çmim e ofruar në një ofertë, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 74, pika 3 dhe me Udhëzimet e APP “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin me mjete elektronike”.

- Për mos ndjekjen e procedurave duke kualifikuar si ofertë të vetmin OE të mbetur në garë, pasi nuk plotëson numrin e punonjësve për vitin 2012, i cili është kriter s`kualifikues, ndërsa tenderi për objektin: “Rikonstruksion i trotuareve, parmakëve dhe ndriçimit në segmentin Ura e Varur - Ura e Gorricës”, duhej të anulohet.

- Për mos ndjekjen e procedurave dhe duke shpallur fitues tenderat: “Rikonstruksion i trotuareve, parmakëve dhe ndriçimit në segmentin Ura e Varur - Ura e Gorricës”, i cili është hapur pas tenderit me objekt “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”, përkatësisht “[REDAKTUAR]”, duke shpallur fitues OE [REDAKTUAR] shpk i cili ka deklaruar në të dy procedurat e prokurimit të njëjtin numër punonjësish, duke mos plotësuar kushtin e kërkuar për kualifikim, si dhe në 11 tendra ka paraqitur të njëjtat makineri e pajisje për të cilat është lidhur kontrata, duke mos plotësuar “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nënpika “Kapaciteti teknik”, si dhe shtojcën 10, pika 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nënpika “Kapaciteti teknik”.

- Për mos ndjekjen, duke kualifikuar në vend të parë të OE [REDAKTUAR] shpk, pasi nuk plotëson kërkesën për përvojë të suksesshme në ekzekutimin e punëve të ngjashme të së njëjtës natyrë, për “Rehabilitimi i fasadave përgjatë bulevardit Republika”, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa c, ç, d, neni 2, germa a, b, c, nenin 51, pika 2, neni 53, pika 1, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 3,842,212 lekë.

- Për mos ndjekjen e procedurës së prokurimit, pasi KVO ka s`kualifikuar BOE [REDAKTUAR] shpk, në mënyrë të padrejtë, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën

5,489,008 lekë dhe duke vlerësuar të rregullta dy ofertat pjesëmarrëse në tender pa informacion ofertën më të ulët të OE “█████ shpk, vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

- Për mos ruajtjen e të dhënave në sistem duke mos siguruar integritetin dhe kofidencialitetin e ofertave e të kërkesave për pjesëmarrje, pasi OE “█████ shp, disponon të dhëna të hollësishme për dokumentacionin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të OE “█████ vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

- Për s`kualifikuar me të padrejtë të OE “█████, me vlerë më të ulët në shumën 9.804.910 lekë, si dhe për mosnjohje nga KVO të kërkesës që dokumentet të jenë lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës”, për vlerësim me dy standarde të vërtetimit për pagesa të maturuara të energjisë elektrike, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 964.515 lekë, vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa c, ç, d, neni 2, germa a, b c.

- KVO, nuk ka kontrolluar çmimet e paraqitura nga OE në ofertat e tyre, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 12 dhe VKM nr. 664, datë 26.09.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 514, datë 15.08.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.”, pika 9.

- Në dy procedura të prokurimit për blerje ushqime për nevoja të Qendrës Ekonomike të Arsimit (kopështe & çerdhe dhe konvikt) për vitin 2014, kanë bërë copëzimin e fondeve, dhe për 21 artikuj është ofruar çmim më të lartë se prokurimi i mëparshëm, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën **111.800 lekë**, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, pika 2 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 2, 57, pika 2.

5 – M.S. në cilësinë e Anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- Për mos ndjekje dhe për kualifikimin e operatorit ekonomi “B...” shpk & “S...” shpk, në kushtet kur nuk plotëson kriteret e përcaktuara në DT. “B...” shpk, nuk plotëson kategoritë e licencës për punimet që ka marrë përsipër të kryejë si dhe numrin e punonjësve të kërkuar në përputhje me përqindjet e përcaktuara në kontratën e bashkimit përkohshëm të OE, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 72 dhe 74, pika 3 dhe Udhëzimet e APP “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin me mjete elektronike”.

- Për mos ndjekjen dhe kualifikimin si ofertë të vlefshme të OE të mbetur në garë në kushtet kur nuk plotëson numrin e punonjësve për vitin 2012, i cili është kriter s`kualifikues dhe tenderi duhej të anulohet, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

- Për mos ndjekjen e proceduarave dhe duke shpallur fitues tenderat: “Rikonstruksion i trotuareve, parmakëve dhe ndriçimit në segmentin Ura e Varur - Ura e Goricës”, i cili është hapur pas tenderit me objekt “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”, përkatësisht “█████ shpk, duke shpallur fitues OE “S...” shpk i cili ka deklaruar në të dy procedurat e prokurimit të njëjtin numër punonjësish, duke mos plotësuar kushtin e kërkuar për kualifikim, si dhe në 11 tendra ka paraqitur të njëjtat makineri e pajisje për të cilat është lidhur kontrata, duke mos plotësuar “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nënpika “Kapaciteti teknik”, si dhe shtojcën 10, pika 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nënpika “Kapaciteti teknik”.

- Për mos ndjekjen e proceduarve duke kualifikuar në vend të parë të OE ██████, pasi nuk plotëson kërkesën për përvojë të suksesshme në ekzekutimin e punëve të ngjashme të së njëjtës natyrë, për “Rehabilitimi i fasadave përgjatë bulevardit Republika”, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa c, ç,

d, neni 2, germa a, b, c, nenin 51, pika 2, neni 53, pika 1, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 3,842,212 lekë.

- Për mos ndjekjen e proceduarve në s`kualifikimin në mënyrë të padrejtë nga KVO të BOE [REDAKTUAR] duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 5,489,008 lekë, si dhe duke mos ruajtur të dhënat në mënyrë që të sigurojnë integritetin dhe kofidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

- Për mos ndjekjen e proceduarve në s`kualifikimin në mënyrë të padrejtë nga KVO të OE [REDAKTUAR] shpk, me vlerë më të ulët të ofruar dhe për lëshimin e dokumenteve jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 964,515 lekë, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, pika 2, germa c, ç, d, neni 2 germa a, b, c.

- Për mos ndjekjen e proceduarve në s`kualifikimin në mënyrë të padrejtë nga KVO, duke mos kontrolluar çmimet e paraqitura nga OE, në lidhje me llogaritjen e kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 514, datë 15.08.2007, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

- Për mos ndjekjen e proceduarve në s`kualifikimin në mënyrë të padrejtë të OE “E...” shpk me vlerë më të ulët, pasi sigurimi i ofertës është sipas kërkesave të DT, duke vepruar me dy standarde për shlyerje të detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 19.180 lekë, ndërsa kjo procedurë prokurimi duhej të anulohet, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

- Për mos kërkimin nga KVO për konfiskimin e sigurimit të ofertës të OE [REDAKTUAR] në kompaninë e sigurimeve [REDAKTUAR] me numër serie 0046675, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 111.800 lekë, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 58, pika 5.

- Për mos ndjekjen e proceduarve për shpalljen fitues BOE “ [REDAKTUAR] shpk, me mangësi në drejtim plotësimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në kushtet kur në kontratën e bashkimit të shoqërive nuk ka të përcaktuar punët konkrete për çdo OE, ndërsa OE [REDAKTUAR] nuk plotëson kriterin e numrit të punonjësve, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 1, datë 01.10.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, pika 2, gerrat a, c.

- Për mos ndjekjen e proceduarve për shpalljen fitues të OE “ [REDAKTUAR] shpk, ndërsa KVO ka klasifikuar BOE, i cili në dy prokurime kanë paraqitur të njëjtat makineri, të njëjtën fuqi punëtore dhe njëkohësisht nuk plotësojnë kushtet për tender. KVO, është e njëjtë për të dy procedurat dhe ka hartuar raportet përmbledhëse për tenderin me objekt “Rikonstrukcion i shëtitorës së bulevardit “Osumi” më datë 26.06.2014 dhe për tenderin me objekt “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale” më datë 27.06.2014, në një kohë që tenderin “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”, nuk duhej ta shpallte fitues pasi nuk plotëson numrin e fuqisë punëtore si dhe kërkesën e “Dokumenta standarde të procedurës së hapur-punë”, shtojca 10, pika 2, nënpika “Kapaciteti teknik”.

6 – L.B. me detyrë Drejtoresh Finance, në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- Për mos ndjekjen e proceduarve për shpalljen fitues të BOE [REDAKTUAR], i cili paraqitet me mangësi në drejtim të plotësimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në kushtet kur në kontratën e bashkimit të përkohshëm të shoqërive nuk ka të përcaktuar punët konkrete, si dhe OE “ [REDAKTUAR] nuk plotëson kriterin e numrit të punonjësve, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 1, datë 01.10.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pika 2, germa a, c.

- Për mos ndjekjen e proceduarve për shpalljen fitues nga KVO të BOE, të cilët në dy prokurime kanë paraqitur të njëjtat makineri, fuqi punëtore duke mos plotësuar procedurat e tenderit. KVO, është e njëjtë për të dy procedurat dhe ka hartuar raportet përmbledhëse për tenderin me objekt “Rikonstruksion i shëtitorës së bulevardit “Osumi”, më datë 26.06.2014 dhe për tenderin me objekt “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale” më datë 27.06.2014, në një kohë që tenderin “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”, nuk duhej të shpallej fitues pasi nuk plotëson numrin e fuqisë punëtore si dhe kërkesën “Dokumenta standarde të procedurës së hapur-punë”, shtojca 10, pika 2, nënpika “Kapaciteti teknik”.

7 – V.Z. me detyrë specialist në Drejtorisë së Investimeve, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

- Për mos ndjekjen e proceduarve për shpalljen fitues të BOE [REDAKTUAR], me mangësi në drejtim të plotësimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në kushtet kur në kontratën e bashkimit të përkohshëm të shoqërive nuk ka të përcaktuar punët konkrete, si dhe OE [REDAKTUAR] nuk plotëson kriterin e numrit të punonjësve, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 1, datë 01.10.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, pika 2, gërmat a, c.

- Për mos ndjekjen e proceduarve për shpalljen fitues nga KVO të BOE, të cilët në dy prokurime kanë paraqitur të njëjtat makineri, fuqi punëtore duke mos plotësuar procedurat e tenderit. KVO, është e njëjtë për të dy procedurat dhe ka hartuar raportet përmbledhëse për tenderin me objekt “Rikonstruksion i shëtitorës së bulevardit “Osumi”, më datë 26.06.2014 dhe për tenderin me objekt “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale” më datë 27.06.2014, në një kohë që tenderin “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”, nuk duhej të shpallej fitues pasi nuk plotëson numrin e fuqisë punëtore si dhe kërkesën “Dokumenta standarde të procedurës së hapur-punë”, shtojca 10, pika 2, nënpika “Kapaciteti teknik”.

8 – R.K. në cilësinë e Kryetarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, dhe me detyrë ish Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Urban, pasi: në hartimin e dokumenteve të tenderit, në procedurat e prokurimit për punë civile, sa vijon: “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale” dhe “Rikonstruksion i shëtitorës së bulevardit “Osumi”, Berat”, kërkesat e veçanta për kualifikim, pjesë e DT, janë të paargumentuara duke kërkuar që Operatorët Ekonomikë që të disponojnë: Nivele të kategorisë së licencës për punime ndërtimi, më të larta se volumet e punimeve të vetë objektit dhe një numër të punonjësve të paargumentuar me volumet e punës, veprim në papajtueshmëri me nenet 8 e 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pasi niveli i punimeve që do të kryhen në këto procedura prokurimi për çdo kategori punimi dhe numri i punonjësve të kërkuar nuk përputhet me volumet e punës.

Për të vërtetuar numrin e punonjësve është kërkuar që të paraqitet edhe formulari i Deklarimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për secilin muaj”, kërkesë e pa argumentuar dhe e fryrë paraqitja edhe e tij pasi listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore, për pagimin e sigurimeve shoqërore, janë nëse të mjaftueshëm dhe të besueshëm për të vërtetuar kërkesën e punësimit dhe të sigurimit të punonjësve, kjo bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 23, datë 09.12.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, të dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, të ndryshuar.

d- Në procedurat e prokurimit “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”, Berat” është kërkuar që OE të

paraqesë dokumentacion për fabrikë betoni, për të cilën kërkohet që: “Për fabrikën e betonit duhet të paraqitet dokumenti i pronësisë, me qira ose certifikata e pronësisë, shoqëruar me leje mjedisore” dhe në dy raste është vendosur kërkesa që fabrika e betonit të mos jetë më larg se 20 km, në një kohë që në procedurat e tjera të prokurimit për punë civile të ngjashme nuk është vendosur ky kufizim, duke vendosur dy standarde në kërkesa dhe duke mos e argumentuar atë. Artikulli “beton” është një mall që gjendet në treg dhe nuk mund të detyrohen subjektet që të kenë në pronësi apo të marrin me qira fabrikë betoni. Qenia edhe pronar i një fabrike betoni mund të përdoret si arsyetim nga subjektet ndërtuese për të justifikuar çmim e ofruar në një ofertë.

e- Nga auditimi rezultoi se në dy procedura prokurimi “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale” dhe “Rikonstruksioni i bibliotekës “V. Buharaja”, është vendosur kërkesa për një numër punonjësish të pajisur me “Dëshmi nga IQT”, në një kohë që në procedurat e tjera të prokurimit për punë civile të ngjashme nuk është vendosur ky kufizim duke vendosur dy standarde në kërkesa.

f- Nga auditimi rezultoi se nga ana e AK në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale”, është vendosur kërkesa që “OE duhet të ketë në stafin e tij dhe të siguruar sipas legjislacionit në fuqi Mjekun e Shoqërisë”. NJHDT në vendosjen e këtij kriteri ka vendosur kufizime kohore, pasi ka kërkuar që OE t’a ketë mjekun e shoqërisë nga muaji dhjetor 2014 e në vazhdim, në një kohë që VKM nr. 741, datë 06.11.2003, pika 3, e kërkon mjekun në mënyrë të përhershme. Kjo kërkesë nuk është vendosur në asnjë nga procedurat e tjera të prokurimit.

Sa më sipër, për përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, është vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa c, ç dhe d, dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, dhe neni 20, “Mosdiskriminimi”, në të cilën kërkohet se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tjera.”, duke shkaktuar pabarazi dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, pasi në procesverbalet e hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit, nuk ka asnjë argumentim dhe nuk justifikohen me volumet e punës kërkesat teknike ekonomike (kategoritë e licencës, numrin e punëtorisë, numrin dhe llojin e mjeteve, etj.), të përcaktuara nga NJHDT.

Në procedurat e prokurimit për punë civile, sa vijon:

- a.** “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional), suplementi i sheshit qendror “T.Muzaka”.
- b.** “Rikonstruksion i trotuareve, parmakëve dhe ndriçimit në segmentin Ura e Varur – Ura e Goricës”.
- c.** “Rehabilitimi i fasadave përgjatë bulevardit Republika”.
- d.** “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuarave dhe unazës perimetrale”.
- e.** “Rikonstruksioni i bibliotekës “V. Buharaja”.
- f.** Rikonstruksioni dhe rikualifikimi i rrugëve në lagjen “Donika Kastrioti”.
- g.** “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”.
- h.** “Rikonstruksion i shëtitores së bulevardit “Osumi”.

Nuk ka asnjë të dhënë për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk ka asnjë urdhër të titullarit të AK për ngritje të grupit të punës për hartimin e detyrës së projektimit, nuk ka asnjë të dhënë dokumentare se si dhe pse është hartuar ky projekt dhe preventiv, për marrjen në dorëzim të projekteve dhe për vërejtjet që mund të ketë, nuk ka asnjë të dhënë nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Investimeve dhe Kontrollit të Projekteve drejtuar NJHDT, për kërkesat e veçanta për kualifikim, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 59, “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pika 1 dhe 2.

- Në hartimin e DT për 4 tenderat me objekt “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (Konviktet)” dhe “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (kopshte & çerdhe)” për vitin 2014, nuk ka asnjë dokumentacion ku të jetë përcaktuar numri i nxënësve që përfitojnë bursën (ushqim e fjetje), frekuentimi dhe mbi çfarë periudhe kohore është bazuar ky komision. Nuk na u vu në dispozicion asnjë analizë e kostos të mallrave, që do të prokurohen duke krahasuar elementët e më sipërm dhe specifikimet teknike të mallrave, punëve dhe shërbimeve përkatëse për të cilën ka dalë vlera limit e kontratave. Nuk ka asnjë të dhënë të paraqitur nga ky grup mbi numrin e nxënësve me burse dhe gjysëm burse. Specifikimet teknike të paraqitura në asnjë rast nuk kanë të përcaktuar treguesit organo leptikë, fiziko kimikë, shqisorë, markerimi, etiketimi, standartet, mënyra e ruajtjes dhe transportimit si dhe cilësia e artikujve të kërkuar.

- Në DT në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 27, “Kontratat e mallrave”, nuk është kërkuar mënyra e vërtetimit të kontratave të ngjashme nga sektori privat, *Nuk është përcaktuar asnjë kërkesë specifike për mjetin*, nga NJHDT, nuk është kërkuar mjet frigoriferik i domosdoshëm për transportin e mishit dhe nënartikujve të tij, bulmetit e vezëve si dhe për transportin e mallrave të tjerë objekt i kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 27, “Kontratat e mallrave”, në specifikimet teknike, janë përcaktuar referenca e markave e konkretisht për artikullin: Makarona Misko e Biskota Piknik, në papajtueshmëri me nenin 23 “Specifikimet teknike”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pika 5, në 50 artikuj e prokuruar, për ushqime në asnjë rast nuk janë përcaktuar treguesit organo leptikë, fiziko kimikë, shqisorë, markerimi, etiketimi, standartet, mënyra e ruajtjes dhe transportimit dhe cilësia e artikujve të kërkuar, objekt prokurimi, në kundërshtim me nenin 23 “Specifikimet teknike”, pika 3 e tij.

- Për tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i shëtitores së bulevardit “Osumi”, Berat”, të zhvilluar në vitin 2014, me vlerë limit të kontratës 136.297.640 lekë, nuk ka oponencë teknike, veprim në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar, neni 6

- Në zhvillimin e 2 procedurave të prokurimit për blerje ushqime për nevoja të Qendrës Ekonomike të Arsimit (kopështe & çerdhe dhe konvikt) për vitin 2014, nga copëzimi i fondeve, duke i pasur ato në dispozicion, në 21 artikuj është ofruar me çmim më të lartë nga njëra procedurë prokurimi në tjetrën, duke vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, “Metodat e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike.”, pika 2, në të cilën është përcaktuar se: “Nuk lejohet pjesëtimi apo ndarja e vlerës së kontratës publike për shmangien nga dispozitat e parashikuara nga ky ligj.”, duke shkaktuar një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit, me pasojë dëm ekonomik në shumën 169.113 lekë, veprim në papajtueshmëri me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 2, “Prokurimi i përqendruar dhe organi qendror blerës” dhe nenin 57, “Njësia e prokurimit”, pika 2.

9 – K.GJ. në cilësinë e Kryetarit të Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit dhe të anëtarit të Komisionit të vlerësimit të Ofertave, pasi:

Në hartimin e dokumenteve të tenderit, në procedurat e prokurimit për punë civile, sa vijon: “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional), suplementi i sheshit qendror “T. Muzaka”, “Rikonstruksion i trotuareve, parmakëve dhe ndriçimit në segmentin Ura e Varur – Ura e Goricës”, “Rehabilitimi i fasadave përgjatë bulevardit Republika”, “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale”, “Rikonstruksioni i bibliotekës “V. Buharaja”, “Rikonstruksioni dhe rikualifikimi i rrugëve në lagjen “Donika Kastrioti”, Berat”, “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalmi i unazës perimetrale” dhe “Rikonstruksion i shëtitores së bulevardit “Osumi”, Berat” kërkesat e veçanta për kualifikim, pjesë e DT, janë të paargumentuara duke kërkuar që Operatorët Ekonomikë që të disponojnë sa vijon: Nivele të kategorisë së licencës për punime ndërtimi, më të

larta se volumet e punimeve të vetë objektit, dhe një numër të punonjësve të paargumentuar me volumet e punës.

veprim në papajtueshmëri me nenet 8 e 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pasi niveli i punimeve që do të kryhen në këto procedura prokurimi për çdo kategori punimi dhe numri i punonjësve të kërkuar nuk përputhet me volumet e punës.

a - Për të vërtetuar numrin e punonjësve është kërkuar që të paraqitet formularët e deklarimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për secilin muaj, nga ku rezulton se është një kërkesë e pa argumentuar dhe e fryrë paraqitja edhe e këtij dokumenti, pasi listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore, për pagimin e sigurimeve shoqërore, janë mese të mjaftueshëm dhe të besueshëm për të vërtetuar kërkesën e punësimit dhe të sigurimit të punonjësve, kjo bazuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 23, datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, të dalë në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, të ndryshuar.

b - Në procedurat e prokurimit “Rikonstruksion dhe rikualifikimi urban i lulishtes perëndimore (loti opsional) dhe suplementi i sheshit qendror “Teodor Muzaka”, Berat” është kërkuar që OE të paraqesë dokumentacion për fabrikë betoni, për të cilën kërkohet që: “Për fabrikën e betonit duhet të paraqitet dokumenti i pronësisë, me qira ose certifikata e pronësisë, shoqëruar me leje mjedisore” dhe në dy raste është vendosur kërkesa që fabrika e betonit të mos jetë më larg se 20 km, në një kohë që në procedurat e tjera të prokurimit për punë civile të ngjashme nuk është vendosur ky kufizim, duke vendosur dy standarde në kërkesa dhe duke mos e argumentuar atë.

c - Nga auditimi rezultoi se në dy procedura prokurimi “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale” dhe “Rikonstruksioni i bibliotekës “V. Buharaja”, është vendosur kërkesa për një numër punonjësish të paisur me “Dëshmi nga IQT”, në një kohë që në procedurat e tjera të prokurimit për punë civile të ngjashme nuk është vendosur ky kufizim duke vendosur dy standarde në kërkesa.

d - Nga auditimi rezultoi se nga ana e AK në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion dhe rikualifikim i parkut “Dëshmorët e Kombit”, trotuareve dhe unazës perimetrale”, është vendosur kërkesa që “OE duhet të ketë në stafin e tij dhe të siguruar sipas legjislacionit në fuqi Mjekun e Shoqërisë”. NJHDT në vendosjen e këtij kriteri ka vendosur kufizime kohore, pasi ka kërkuar që OE t’a ketë mjekun e shoqërisë nga muaji dhjetor 2014 e në vazhdim, në një kohë që VKM nr. 741, datë 06.11.2003, pika 3, e kërkon mjekun në mënyrë të përhershme. Kjo kërkesë nuk është vendosur në asnjë nga procedurat e tjera të prokurimit.

Sa më sipër, për përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, është vepruar në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa c, ç dhe d, dhe neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, dhe neni 20, “Mosdiskriminimi”, në të cilën kërkohet se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tjera.”, duke shkaktuar pabarazi dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, pasi në procesverbalet e hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit, nuk ka asnjë argumentim dhe nuk justifikohen me volumet e punës kërkesat teknike ekonomike (kategoritë e licencës, numrin e punëtorisë, numrin dhe llojin e mjeteve, etj.), të përcaktuara nga NJHDT.

Në hartimin e DT për 4 tenderat me objekt “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (Konviktet)” dhe “Blerje ushqime për nevoja të furnizimit QEA (kopshte & çerdhe)” për vitin 2015, nuk ka asnjë dokumentacion ku të jetë përcaktuar numri i nxënësve që përfitojnë bursën (ushqim e fjetje), frekuentimi dhe mbi çfarë periudhe kohore është bazuar ky komision. Nuk na u

vu në dispozicion asnjë analizë e kostos të mallrave, që do të prokurohen duke krahasuar elementët e më sipërm dhe specifikimet teknike të mallrave, punëve dhe shërbimeve përkatëse për të cilën ka dalë vlera limit e kontratave. Nuk ka asnjë të dhënë të paraqitur nga ky grup mbi numrin e nxënësve me burse dhe gjysëm burse. Specifikimet teknike të paraqitura në asnjë rast nuk kanë të përcaktuar treguesit organo leptikë, fiziko kimikë, shqisorë, marketimi, etiketimi, standartet, mënyra e ruajtjes dhe transportimit si dhe cilësia e artikujve të kërkuar. Në DT nuk është kërkuar mënyra e vërtetimit të kontratave të ngjashme nga sektori privat. *Nuk është përcaktuar asnjë kërkesë specifike për mjetin*, nga NJHDT, nuk është kërkuar mjet figuriferik i domosdoshëm për transportin e mishit dhe nënartikujve të tij, bulmetit e vezëve si dhe për transportin e mallrave të tjerë objekt i kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 27, “Kontratat e mallrave”. Në DT, në specifikimet teknike, janë përcaktuar referenca e markave e konkretisht për artikullin: Makarona Misko e Biskota Piknik, në 50 artikuj e prokuruar, në asnjë rast nuk janë përcaktuar treguesit organo leptikë, fiziko kimikë, shqisorë, marketimi, etiketimi, standartet, mënyra e ruajtjes dhe transportimit dhe cilësia e artikujve të kërkuar, objekt prokurimi, në pajtueshmëri me nenin 23 “Specifikimet teknike”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, pika 3 dh 5.

Nga auditimi i dy procedurave me të njëjtin objekt “Blerje ushqime”, të zhvilluara brenda një muaji me urdhër prokurimi nr. 6, datë 12.02.2015 dhe nr. 11, datë 16.03.2015, rezulton se AK, ka bërë copëzimin e fondit prej 7.399.465 lekë duke i pasur fondet në dispozicion, duke vepruar në pajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 28, “Metodat e përlogaritjes së vlerës në kontratat publike.”, pika 2.

“Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”, ka klasifikuar e shpallur fitues BOE “██████████” shpk me mangësi në drejtim plotësimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në kushtet kur në kontratën e bashkimit të përkohshëm të shoqërive nuk ka të përcaktuar punët konkrete që do të kryejë cdo OE, ██████████ nuk plotëson kriterin e numrit të punonjësve në këtë BOE, veprim në pajtueshmëri me VKM nr. 1, datë 01.10.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 2, “Bashkimi i operatorëve ekonomike”, gërmat a dhe c, OE “██████████” për muajt shkurt, mars e prill 2014 ka paraqitur dy numra të ndryshëm punonjësish, OE “██████████” nuk ka certifikatë PAS 99 – 2002.

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”, ka klasifikuar e shpallur fitues BOE ██████████ me mangësi në drejtim plotësimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në kushtet kur në kontratën e bashkimit të përkohshëm të shoqërive nuk ka të përcaktuar punët konkrete që do të kryejë cdo OE, OE “██████████” nuk plotëson kriterin e numrit të punonjësve në këtë BOE, veprim në pajtueshmëri me VKM nr. 1, datë 01.10.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, “Kushte të përgjithshme për zbatim”, pika 2, “Bashkimi i operatorëve ekonomike”, gërmat a dhe c, OE “██████████” shpk për muajt shkurt, mars e prill 2014 ka paraqitur dy numra të ndryshëm punonjësish, OE “██████████” shpk nuk ka certifikatë PAS 99 – 2002.

Nga auditimi i dy procedurave të prokurimit: “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale” dhe “Rikonstruksion i shëtitores së bulevardit “Osumi”, në të cilat janë shpallur fitues përkatësisht BOE “██████████”, me data miratimi nga Titullari i AK përkatësisht 27.06.2014 dhe 26.06.2015, me datë lidhje kontrate përkatësisht 08.07.2014 dhe 14.07.2014, dhe me të njëjtën shtrirje kohore të afatit të kontratës ka rezultuar se KVO ka klasifikuar të parin këtë BOE, të cilët në dy procedura prokurimi kanë paraqitur të njëjtat makineri, kanë paraqitur të njëjtën fuqi punëtore dhe njëkohësisht nuk e plotësojnë atë për të dy procedurat. KVO, e cila është e njëjtë për të dy procedurat ka hartuar raportet përmbledhëse për tenderin me objekt “Rikonstruksion i shëtitores së bulevardit “Osumi”, Berat” më datë 26.06.2014 dhe për tenderin me objekt “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale” më datë 27.06.2014, në një kohë që për tenderin “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”, nuk duhej ta

shpallte fitues BOE pasi nuk e plotëson numrin e fuqisë punëtore si dhe kërkesën e “Dokumenta standarde të procedurës së hapur – punë”, shtojca 10, pika 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nën-pika “Kapaciteti teknik”. KVO nuk duhej ta shpallte fitues këtë BOE për procedurën “Rivitalizimi i parkut perëndimor të qendrës dhe nënkalimi i unazës perimetrale”.

D. 2. MASA ADMINISTRATIVE

a- Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), Bashkia Berat.

Mbështetur në ligjin nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” dhe nenin 15 “Sanksionet”, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, i kërkojmë:

Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore të Bashkisë Berat, që ka në juridiksion territorin ku ndodhet objekti i trajtuar sipas kontratave, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur sanksionet **Dënimin me gjobë** për mbikëqyrësin e punimeve:

- **B.S.** administrator i subjektit [REDAKTUAR], mbikëqyrës i punimeve, me licencë nr. MK 1554/6, me të cilin është lidhur kontrata nr. 1548/2, datë 14.07.2014, për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për objektin “Rikonstruksion i Shëtitores “Osumi” (Aksi kryesorë L = 83.10 ml, aksi1 L = 82.40 ml)”, Bashkia Berat, për shkak se:

- Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyrojnë me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i situacionimit të katër zëra punimesh, me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën **5,992,146 lekë** pa TVSh, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga bashkimi i operatorëve ekonomik [REDAKTUAR]

- Gjatë zbatimit të kontratës për ndërtimin e objektit “Rikonstruksion i Shëtitores “Osumi” Berat (Aksi kryesorë L = 83.10 ml, aksi1 L = 82.40 ml)”, në disa raste nuk janë realizuar prova laboratorike dhe mungojnë certifikata e cilësisë për materialet e përdorura për ndërtimin e objektit. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”.

b- Për Ministrinë Zhvillim Urban (Për Komisionin e Licencave)

Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për Licencimin Profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit” dhe në nenin 13, nenin 25 dhe pika 1/a, 1/e, e nenit 41, Kreu VI-të, “Sanksione dhe Dispozita kalimtare”, për shkelje të ligjshmërisë në studim projektim e hartim preventivi në fushën e ndërtimit, **i rekomandojmë** Komisionit të Licencave, pranë Ministrisë Zhvillim Urban, **Heqjen e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim** (heqjen e Licencës profesionale), për një afat deri nga 2-3 vjet, si më poshtë:

1. Për subjektin “[REDAKTUAR] shpk, me administrator z. K.M, me licencë nr. MK 1007, për shkak se:

1 - Ka hartuar projektin e ndërtimit të objektit, duke mos zbatuar kushtet teknike të projektimit, pasi projekti i zbatimit dhe preventivi i hartuar për përcaktimin e vlerës së objektit, “Rikonstruksion i Shëtitores “Osumi” Berat (Aksi kryesorë L = 831 ml, aksi1 L = 82.4 ml)”, Bashkia Berat, nuk kanë saktësinë e duhur, për rrjedhojë, ka sjellë rritjen e vlerës totale të preventivit të tenderuar, në vlerën **2,453,038 lekë** pa TVSh, në papajtueshmëri me nenin 5, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të

ndryshuar, me germën “b”, të pikës 3.1, të UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

2- Ka hartuar projektin e ndërtimit të objektit, duke mos zbatuar kushtet teknike të projektimit, pasi projekti i zbatimit dhe preventivi i hartuar për përcaktimin e vlerës së objektit “Rikonstruksion i trotuarit, parmakëve dhe ndriçimit në segmentin Ura e Varur-Ura e Gorricës”, Bashkia Berat, nuk kanë saktësinë e duhur, për rrjedhojë, ka sjellë rritjen e vlerës totale të preventivit të tenderuar, në shumën **4,103,100 lekë** pa TVSh, veprim në papajtueshmëri me nenin 5, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me germën “b”, të pikës 3.1, të UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar dhe VKM nr. 568, datë 27.06.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Berat për:

1. K.GJ. me detyrë ish-Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe në cilësinë e Kryetarit të KVO.

2. M.K. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe në cilësinë e anëtarit të NJHDT.

3. E.P. me detyrë ish-N.Kryetare e Bashkisë dhe në cilësinë e Kryetarit të KVO.

4. E.I. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Aseteve dhe Strehimit dhe në cilësinë e anëtarit të KVO.

5. L.B. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Strehimit dhe në cilësinë e anëtarit të KVO.

6. R.K. me detyrë ish-Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe në cilësinë e Kryetarit të KVO,

pasi kanë kryer veprime të kundërligjshme të cilat referuar përmbajtjes së dispozitës penale, neni 248 dhe neni 258 i Kodit Penal, mbartin elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”.

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

E.1 INDICIE PËR KALLËZIM PENAL

Bazuar në nenin 281 të Kodit Penal, përcillen në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Berat, Indiciet Penale për:

1. H.D. me detyrë Juriste e Drejtorisë Juridike dhe në cilësinë e anëtarit të NJHDT.

2. F.K. me detyrë Juriste e Drejtorisë Juridike dhe në cilësinë e anëtarit të KVO.

3. V.Z. me detyrë Specialiste e Investimeve në Drejtorinë e Investimeve, Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe në cilësinë e anëtarit të KVO.

4. R.K. me detyrë ish-Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe në cilësinë e Kryetarit të KVO dhe NJHDT.

5. B.B. me detyrë N/Kryetar dhe për Komisionin e Shpronësimeve/

- 6. T.H.** me detyrë Specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Shpronësimeve.
- 7. D.T.** me detyrë Specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Shpronësimeve.
- 8. D.T.** me detyrë Jurist i Drejtorisë Juridike dhe anëtarit të Komisionit të Shpronësimeve.
- 9. F.SH.** me detyrë Specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Shpronësimeve.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R